



80 të rinj nisin rrugëtimin akademik në moton “Atdheu, Nderi, Detyra”



80 të rinj nisin rrugëtimin akademik në moton “Atdheu, Nderi, Detyra”

Viti akademik 2024-2025, ashtu si në të gjithë vendin startoi dhe për të rinjtë dhe të rejt e Forcave të Armatosura. Në ceremoninë e organizuar nga Akademia e Forcave të Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes morën pjesë autoritete të larta si, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, ministri i Arsimit dhe Sportit znj. Ogerta Manastirliu, ministri i Mbrojtjes i Kosovës, z. Ejup Maqedonci, komandantë të forcave, drejtorë të MM dhe SHPFA, rektorë të universiteteve, studentë, personeli akademik, si dhe drejtues të AFA-së.

Ceremoninë e hapi gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, komandant/rektori i AFA-së, i cili në fjalën e tij përshëndetëse u shpreh se: “Dita e sotme mbart shumë emocione për të gjithë ne, por në mënyrë të veçantë për 80 studentët e rinj, përfshirë dhe ata nga Republika e Kosovës, të cilët, kanë vendosur t’i përkushtohen një prej profesioneve më fisnike dhe më të nderuara, profesionit të ushtarakut. Ju keni bërë zgjedhjen e duhur për t’u arsimuar në Akademinë e FA-së. Këtu ju do të përgatiteni si liderë të së ardhmes të FARSH, për t’i shërbyer me devotshmëri atdheut, për të kontribuar në sigurimin e paqes kudo në botë, të rreshtuar me krenari “krah për krah” aleatëve tanë të NATO-s.

Akademia e Forcave të Armatosura, duke ndjekur modelin e Akademisë Ushtarake të SHBA-ve, ‘West Point’, vjen sot si një Institucion i Arsimit të Lartë edhe më i konsoliduar, duke hapur dyert e saj për 315 studentë, me gjashtë programe studimi në ciklin e parë, Bachelor, dhe tre programe të ciklit të dytë, dy prej të cilëve ofrohen për herë të parë: Master Shkencor në ‘Siguri dhe Politikë Ndërkombëtare’ dhe ‘Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale’.

Intensifikimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, është dhe do të mbetet prioritet i Akademisë së Forcave të Armatosura, me qëllim thellimin, zgjerimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe rritjen e ofertës akademike, duke përfshirë dhe hapjen e ciklit të tretë, të studimeve, programin PHD, brenda vitit akademik 2026, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Akademisë së Forcave të Armatosura.

Me prioritet të veçantë gjithashtu është parë edhe përmirësimi i infrastrukturës. Falë një investimi serioz nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, AFA po ndërton një prej kampuseve më modernë të arsimit të lartë në vend, për të ofruar një edukim me kushte moderne, të mirë pajisur me laboratorë, mjete didaktike dhe teknike bashkëkohore”.

Më tej gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj



falënderoi Ministrin e Mbrojtjes, Ministren e Arsimit dhe Sportit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, për mbështetjen e vazhdueshme që i japin Akademisë së Forcave të Armatosura në procesin e vazhdueshëm të transformimit.

Në fund, gjeneral brigade Nuredinaj u përcolli një falënderim të veçantë stafit akademik, administrativ dhe personelit komandues, të cilët punojnë me profesionalizëm dhe përkushtim për të bërë të mundur edukimin dhe farkëtimin e gjeneratave të studentëve ushtarakë me vlerat më të mira qytetare dhe ushtarake.

Më tej në fjalën e rastit Ministri i Arsimit dhe Sportit, znj. Ogerta Manastirliu u shpreh se ndihet e nderuar që ndodhet në këtë ceremoni me cilësinë e Ministres së Arsimit dhe sportit, por dhe si bijë e një oficeri të mbrojtjes. “Jam krenare, sepse për pak vite është dyfishuar numri i aplikuesve për AFA-në, ku para disa vitesh kemi qenë me rreth 600 aplikime për rreth 70 vende për ciklin e parë të studimeve dhe sot kemi rreth 1200 aplikime. Sigurisht që sfidat janë të shumta edhe për AFA-në, ashtu sikurse për të gjithë sistemin tonë të arsimit të lartë universitar, ku së bashku

jemi duke u përpjekur për të përballuar sfidat e kohës, ku në universitete të ndryshme shfaqen sfida të ndryshme lidhur me sfidat e teknologjisë, informacionit dhe sfidat që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë, sfida që lidhen me shkencat ekzakte, sfida që lidhen me formimin e profesionistëve të ndryshëm të shumë fushave. Sigurisht jam këtu sot edhe për të thënë se Ministria e Arsimit dhe Sportit do të vijojë me dedikim të mbështesë AFA-në, pasi AFA ka një status të veçantë dhe gjithashtu kemi punuar së bashku për të arritur drejt akreditimit institucional, faza e të cilit është





drejt përfundimit, dhe shumë shpejt do të kemi një përfundim të kësaj detyre të madhe që është akreditimi institucional i AFA-së, në bazë të akreditimit të të gjithë cikleve të studimit. Jam gjithashtu e kënaqur të them se jo vetëm kemi arritur që të realizojmë dhe një objektivi tjetër për sa i përket ciklit të integruar të studimeve, por kjo Akademi është duke u përshtatur me standardet më të mira Akademisë “West Point”, të SHBA-ve, dhe ne si Ministri e Arsimit dhe Sportit jemi të gatshëm që të ofrojmë të gjithë lehtësitat e mundshme në çdo element që ka të bëjë me programin e studimit, por gjithashtu edhe me lehtësimin në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit dhe të profilizimit të ndryshëm.

Një vlerë e shtuar e kësaj ceremonie ishte dhe ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, zoti Ejup Maqedonci, i cili në fjalën e tij përshëndetëse do të shprehte emocionet e tij të veçanta: “Përveç faktit që jam një shqiptar i Kosovës, me Shqipërinë, dhe veçanërisht me ushtrinë shqiptare, më lidh e kaluara e tashmja dhe padyshim që do të më lidhë edhe e ardhmja. Në një kohë e rrethana krejtësisht të tjera, këtu në Shqipëri, në mars të vitit 1998, pikërisht nga një ish-oficer shqiptar nga Tirana, i quajtur Adem Shehu, mora njohuritë e para, para luftës në Kosovë. Ademin më vonë do ta kisha edhe komandant brigade gjatë luftës në Kosovë. Në Shqipëri do të vija më pas edhe shumë herë të tjera si komandant i kontingjentit të FSK-së, gjatë përmbajtjeve në qarkun e Shkodrës në vitin 2010; si oficer planifikues në shumë aktivitete të përbashkëta; si vizitor i bukurive natyrore të Shqipërisë, por edhe si një ndër tifozët e parë të tifo-klubit “Tifozët Kuq e Zi”, për të ndjekur ndeshjet e kombëtares sonë. Sot në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, i ftuar nga ministri Vengu, erdha këtu për të shënuar një datë të veçantë për ju kadetë të dashur, datë që shënon fillimin e formësimit tuaj akademik dhe profesional, rrugëtim ky krejt i veçantë dhe në thelb i jashtëzakonshëm. Padyshim profesioni i ushtarakut por edhe edukimi në këtë profesion kërkon mund e sakrificë, përpjekje e angazhim, por ju jep mundësinë që t’i shërbeni Atdheut, kjo mundësi nuk jepet shpesh në jetë. Njeriu mund të ketë shanse e mundësi për t’u zhvilluar e për të punuar për vetveten gjatë gjithë jetës, por për

të marrë pozitë publike, ku mund t’i shërbesh të tjerëve e para së gjithash Atdheut tënd është mundësi e rrallë, e çmuar. Duajeni këtë profesion, jepni më të mirën që ka secili nga vetja, do t’ju bëjë krenarë gjithë jetës, juve, familjen dhe fëmijët tuaj në të ardhmen. Dy ministratë tona në vazhdimësi, por në veçanti në periudhën e fundit kanë rritur, thelluar dhe zgjeruar bashkëpunimin e ndërsjellë. Trajnimet e ushtrimit e përbashkëta edukimi i kadetëve të të dyja vendeve në akademitë ushtarake të Shqipërisë dhe Kosovës dhe bashkëpunimi në fushat e tjera, përveçse janë duke ndikuar në shkëmbimin e njohurive, po ndihmojnë edhe në ndërtimin e raporteve ndërpersonale të ushtarakëve tanë, duke lidhur kështu edhe më shumë kombin që jeton në dy shtetet tona”.

Ministri Maqedonci do të vinte theksin e tij se: “Në këtë kohë të ndryshimeve në ambientin strategjik të sigurisë, ku siguria e përgjithshme është shndërruar në çështje kryesore edhe në nivel global, bashkëpunimi mes nesh nuk është vetëm i nevojshëm por edhe i domosdoshëm. Gjersa kërcënimet i kemi të përbashkëta, është e pashmangshme që edhe qasjen dhe veprimet tona karshi këtyre kërcënimeve t’i kemi të përbashkëta. Përmes bashkëpunimit në fushat e stërvitjes dhe edukimit ushtarak, përveç trajnimit dhe zhvillimit individual të ushtarakëve tanë u mundësojmë dhe ndërtimin e ndërveprimit taktik dhe operacional të forcave tona ushtarake.

Të dashur kadetë, në këtë ditë të shënuar për ju, familjet tuaja e për të gjithë ne, ju uroj rrugëtim të suksesshëm në zhvillimin tuaj profesional dhe akademik. Qëndroni të bindur në zgjedhjen tuaj për profesionin fisnik të ushtarakut. Ju përshëndes në emër të qeverisë së Republikës së Kosovës, ju përcjell urimet e kadetëve të FSK-së. Një ditë do të jeni krah për krah me ta, duke u stërvitur në misione paqeruajtëse bashkë me ushtarë të tjerë të shteteve aleatë tanë. Nderojeni Shqipërinë, nderojeni Kosovën, nderojeni kombin!”.

Ceremonia e fillimit të vitit të ri akademik u përshëndet dhe nga Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, z. Piro Vengu, i cili mes të tjerash u shpreh: “Është një përgjegjësi e madhe që t’i adresosh kësaj rruge, të cilën e keni marrë me vendosmëri, por edhe një farë risku, duke vendosur që të hyni në një rrugë akademike

ndryshe nga të tjerat, një rrugë akademike e cila përmban jo vetëm përgatitjen nga ana mësimore, përgatitjen fizike, por edhe përgatitjen morale. Synimi që kemi bashkë me stafin akademik, me të cilët kemi ndërtuar një marrëdhënie të posaçme bashkëveprimi është që ta kthejmë Akademinë e Forcave të Armatosura në një shkollë komandimi, e cila ofron edhe njohuritë më të fundit, me programet e saj akademike, por ofron gjithashtu një karrierë të sigurt, një karrierë sfiduese me të gjitha avantazhet e benefitet që sjell uniforma. Qeveria Rama ndër vite ka mundësuar që uniforma të jetë ajo që nderohet dhe kjo uniformë të ketë gjithashtu jo vetëm përgjegjësitë por edhe benefitet që i takojnë, qoftë nga pikëpamja e pagës, qoftë nga pikëpamja e motivimit profesional dhe ana e mbështetjes së familjeve të ushtarakëve tanë. I përmend këto sepse është padyshim privilegj veshja e uniformës, janë të paktë ata që e kanë këtë privilegj. Ne synojmë që të jenë edhe më shumë në të ardhmen, ndaj dhe investojmë fuqishëm në mënyrë që akademia të hapet edhe më shumë në të gjithë spektrin e njohurive bashkëkohore, padyshim

rikula të caktuara e të specializuara, së bashku me mbështetjen e ministres së Arsimit, do të synojmë që përmes universiteteve të tjera në vend të mundësojmë programe me formime të dyfishta për inxhinierë të specializuar, për inxhinierë të prodhimit të armatimit, si dhe inxhinierë në fushën e mbrojtjes kibernetike apo të teknologjive, që iu nevojiten forcave për të ushtruar secili detyrën e tyre”. Më tej ministri Vengu theksoi se ka ardhur momenti që forcat e armatosura në tërësi ta shohin përgjegjësinë e tyre përtej detyrave të mbrojtjes së integritetit dhe sovranitetit të vendit, të cilat janë parësore dhe do të vijojnë të mbeten të tilla. “Ne së bashku me gjeneralët e Shtabit dhe stafin pedagogjik të AFA-së, kemi bindjen që Forcat e Armatosura do të luajnë rolin e një skuadre, e cila përpilon dhe përgatit burime njerëzore si kapacitet kombëtar, që t’i vlejnjë kombit jo vetëm si forca të armatosura, por edhe në fusha të tjera civile dhe është shumë e rëndësishme që t’ju japin mundësinë në karrierën tuaj që të vijoni dhe karrierën civile dhe të riktheheni në Forcat e Armatosura dhe të



duke investuar më shumë në teknologjinë e informacionit dhe mbrojtjen kibernetike. Gjithashtu kemi biseduar me të gjithë Shtabin, kohët e fundit, mënyrën më të mirë se si akademia jonë t’i përgjigjet nevojave të strategjisë kombëtare të mbrojtjes dhe strategjisë kombëtare të industrisë ushtarake. Ndaj, aty ku akademia nuk mund të ofrojë kur-

keni një ecure karriere të gjithanshme, sepse janë të pranishme sidomos në vendet më të zhvilluara të NATO-s, kanë krijuar një marrëdhënie shumë dinamike mes uniformës, jetës civile, rikthimit në uniformë, sipas nevojave të vendit në momente të caktuara”, - do të mbyllte fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Vengu.



Emergjencat Civile, ministri Vengu, thirrje kryebashkiakëve: Shfrytëzoni fondin e pakushtëzuar, aplikoni me projekte

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu mori pjesë në takim në thirrur nga kryeministri Edi Rama me kryetarë të bashkive të vendit dhe ministrat Albana Koçiu e Arbjan Mazniku, për bashkëpunimin në interes të komunitetit për të diskutuar për platformat e dialogut, emergjencat civile dhe ndihmat sociale.

Ministri i Mbrojtjes bëri një raport të situatës së zjarreve për periudhën qershor-shtator, duke thënë se janë shuar më shumë se njëmijë zjarre. Ministri Vengu u shpreh se, fatmirësisht ky sezon ka qenë pa fatalitete, por, theksoi ai, dëmet mbeten të konsiderueshme tek komunitetet rurale. Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes foli për tri instrumente që janë në dispozicion të drejtuesve vendorë për t'i ardhur në ndihmë komunitetit.

“Fondi i kushtëzuar për mbrojtjen civile sivjet ka qenë prej 800 milionë lekësh, afërsisht 8 milion euro, i shpërndarë në të gjitha njësitë vendore. Kemi kryer një monitorim të mënyrës sesi ky fond i kushtëzuar është shpenzuar”, - tha ministri Vengu. Ai nënvizoi se: “Ka bashki të vogla që e kanë shpenzuar shumë mirë dhe ka paradoksalisht bashki të mëdha, me resurse financiare të mjaftueshme, që nuk e kanë shpenzuar ende, ndaj do të ftoja të gjithë kryetarët e bashkive që të vijonit, teksa jemi në fund të sezonit të zjarreve, por edhe në fillim të sezonit të përmbajtjeve, ku në terren janë të gjithë ekipet tuaja që bëjnë evidencat e dëmeve, të shfrytëzoni këtë moment, sepse i gjithë financimi i fondit të kushtëzuar ju jep mundësinë që të vini në ndihmë të qytetarëve për dëmshpërblime”.

Ministri i Mbrojtjes iu tha krye bashkiakëve se kanë 60% të këtij fondi në dispozicion për të realizuar dëmshpërblimet dhe është një instrument shumë domethënës që qeveria e ka vendosur në dispozicion. Sipas tij, instrumenti i dytë ka të



bëjë me projektet parandaluese në infrastrukturë, për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. “Vitin e kaluar ishte një fond prej 1 miliard e 570 milionë lekë të reja. Në fakt disbursimi ka ndodhur në dy këste, një pjesë në 2023-in, një pjesë në 2024-ën. Kemi vënë re që i gjithë fondi i alokuar në fakt

është kontraktuar nga shumica e bashkive, por mbeten ende 14 projekte me kontrata të palidhura dhe, do të ftoja kryetarët e bashkive, që të vijonin sa më shpejt me finalizimin e tyre në mënyrë që këto fonde të mos digjen, por të vendosen në eficiencë të plotë”, - tha z. Vengu.

Ndërsa elementi i tretë, sipas ministrit të Mbrojtjes, ka të bëjë me projektin e digave: “Edhe këtu kemi 14 projekte fituese. 8 projekte në fazë lidhje kontrate dhe 6 projekte në përfundim procesi prokurimi. Edhe këtu do të doja një vëmendje të shtuar, sepse fondi i përbashkët, digat dhe projektet infrastrukturore, këtë vit ka qenë i konsiderueshëm, afërsisht 1 miliard e 800 milion lekë të reja dhe ne do vijojmë sigurisht që të alokojmë një fond identik edhe për vitin 2025”, - u shpreh ministri Vengu.

Nga ky takim, ministri i Mbrojtjes njoftoi drejtuesit vendorë se: “Këtë muaj do të bëhet një thirrje për projekte të reja, projekte që mund t'i keni ekzistuese. Unë kam nxitur në fakt, gjatë gjithë këtyre muajve, kryetarët e bashkive që të na dërgojnë projekte infrastrukture, qoftë për digat, qoftë për masat parandaluese, për kanale, për ura në zona të caktuara me vështirësi aksesit, në mënyrë që brenda këtij muaji të bëjmë thirrjen dhe marrjen e të gjitha projekteve nga ju, t'i analizojmë bashkë me emergjencat civile dhe me stafet tuaja dhe të bëjmë renditjen e cilësisë së projekteve, në mënyrë që brenda tetorit, teksa jemi në proces finalizimi të ligjit të buxhetit 2025, të alokojmë fondin.

Dhe kjo ju jep mundësi që të filloni punën që në dhjetor praktikisht. Ju jep mundësi që të përgatisni në mënyrë sa më efikase sezonin tjetër”, - tha ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu.

Shqipëria, mbështetëse e aspiratave të Kosovës në integrimin e saj euroatlantik

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu priti në një takim ministrin e Mbrojtjes së Kosovës z. Ejup Maqedonci dhe delegacionin që e shoqëronte.

Ministri Vengu i uroi mirëseardhjen homologut të tij, ndërsa e cilësoi Kosovën një nga prioritetet kryesore kombëtare të Shqipërisë. Gjatë bashkëbisedimit, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu theksoi se, institucioni që drejton është tejet i angazhuar në përpjekjet për përfshirjen dhe anëtarësimin e Kosovës në iniciativa rajonale e ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe një prej nismave të rëndësishme siç është ajo e Kartës së Adriatikut A5, që këtë vit zhvillohet në Shqipëri.

“Shqipëria mbështet aktivisht aspiratat e Kosovës për integrim euroatlantik. Ajo është aktive brenda NATO-s në mbështetje të forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të Kosovës me Aleancën Atlantike”, - është shprehur ministri Vengu.

Ndërsa dënoi sulmet ndaj Policisë së Kosovës, ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë vlerësoi se dialogu Kosovë – Serbi, nën koordinim me partnerët strategjikë të Kosovës, SHBA dhe BE duhet të ketë si rezultat



përfundimtar një marrëveshje të detyrueshme ligjore, që mundëson njohjen e ndërsjelltë mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE si dhe trajtim të drejtë të minoriteteve, konform Kushtetutës së Kosovës.

Gjatë këtij takimi, ministri i Mbrojtjes vlerësoi bashkëpunimin intensiv në fushën e Mbrojtjes mes dy vendeve dhe veçanërisht mes Forcave të Armatosura të RSH dhe FSK. Sipas ministrit Vengu, janë realizuar shumë aktivitete në kuadër të planit të bashkëpunimit vjetor, duke theksuar këtu bashkëpunimin konkret në ofrimin e kurseve, trajnimeve të organizuara kryesisht nga Forca Tokësore dhe Forca Ajrore, por edhe duke ofruar ekspertizën për zhvillimin e mëtejshëm të Forcave Speciale, në trajnimet për “teknik helikopteri” si dhe kryerjen fluturimeve rifreskuese të pilotëve të FSK-së.

Një tjetër pikë e bashkëpunimit mes dy Ministrive të Mbrojtjes është edhe ai në fushën e arsimit. Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu u shpreh se për këtë vit Akademia e Forcave të Armatosura ka ofruar 10 kuota për sistemin arsimor bachelor, për studentët dhe oficerët nga Kosova. Sipas ministrit Vengu qëllimi është që, ato të shtohen, ndërsa theksoi se bursa janë ofruar edhe për kurset institucionale në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Ministrat e Mbrojtjes së dy vendeve ranë dakord për thellimin e bashkëpunimit edhe në fushat e çminimit të brezit kufitar ndërmjet dy vendeve për të krijuar një mjedis të sigurt për popullsinë lokale, krijimin e kapaciteteve të përbashkëta të Mbrojtjes Civile për t'iu përgjigjur emergjencave, kryesisht për bashkitë kufitare në të dyja anët e kufirit, si dhe dhënien e asistencës së nevojshme për konsolidimin e mëtejshëm të qendrës rajonale për emergjencat civile.



Qeveria shqiptare rrit trajtimin financiar për 6000 efektivë të FA-së

Këshilli i Ministrave miratoi në mbledhjen e tij, me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes, vendimin që përmirëson ndjeshëm trajtimin financiar të personelit të Forcave të Armatosura. Ky vendim synon të forcojë kapacitetet kombëtare dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të Mbrojtjes Civile.

Rreth 6000 efektivë do të përfitojnë nga ky vendim; 2500 prej tyre e marrin për herë të parë shtesën mbi pagën.

Trajtim më të mirë financiar do të përfitojnë edhe kapacitete kombëtare si: forcat speciale, pilotët, inxhinierët dhe teknikët e mirëmbajtjes, njësi Cyber, dronët, forcat e dedikuara për emergjencat civile dhe shumë e shumë kapacitete të tjera.

- Trajtimi financiar për personelin fluturues dhe mbështetës, sipas këtij vendimi, do të variojë deri në 100.000 lek mbi pagën në muaj dhe nga ky vendim përfitojnë rreth 200 ushtarakë.

- Për efektivët e Agjencisë së Inteligjencës, trajtimi financiar mbi pagën shkon deri në 20.000 lek në muaj për rreth 150 ushtarakë.

- Për ushtarakët aktivë të strukturave të tjera, shtesa mbi pagën shkon deri në 70.000 lek në muaj, duke përfshirë edhe ata ushtarakë që nuk e kanë përfituar më parë këtë shtesë.

Ky vendim vjen vetëm 4 muaj pas rritjes së pagave që u bë për kategori të caktuara të Forcave të Armatosura.

Prej vitit 2022 pagat e efektivëve të FA-së kanë pësuar rritjen më të madhe në histori, prej gati 40%.

Ministria e Mbrojtjes dhe qeveria janë të angazhuara të investojnë që trajtimi financiar i efektivëve të FA-së të shtohet çdo vit, për t'i përafëruar me nivelin mesatar të vendeve të Aleancës së NATO-s, duke e konsideruar njëkohësisht një investim për sigurinë kombëtare.



MINISTRIA E MBROJTJES DHE QEVERIA JANË TË ANGAZHUARA TË INVESTOJNË QË TRAJTIMI FINANCIAR I EFEKTIVËVE TË FA-SË TË SHTOHET ÇDO VIT, PËR T'I PËRAFRUAR ME NIVELIN MESATAR TË VENDEVE TË ALEANCËS SË NATO-S, DUKE E KONSIDERUAR NJËKOHËSISHT NJË INVESTIM PËR SIGURINË KOMBËTARE.

Ministri Vengu: Shqipëria e përkushtuar ndaj NATO-s për të ofruar siguri dhe stabilitet në rajon

Ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Pirro Vengu mori pjesë në Ministerialin e Iniciativës ADRIAN (Adriatic and Ionian Initiative), që u mbajt në Venecia. Gjatë fjalës së tij, ministri Vengu falënderoi homologun italian Guido Crosetto për pritjen, ndërsa theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për të siguruar stabilitetin dhe sigurinë në rajonin Adriatiko-Ionian.

“Pas nënshkrimit të Deklaratës së Ankonës, Iniciativa ADRIAN është bërë një platformë për nxitjen e sigurisë në zonën tonë detare. Forcat tona Detare janë angazhuar në shumë aktivitete për të forcuar bashkëpunimin dhe përmirësimin e ndërveprimit”, - tha ministri Vengu.

Duke sjellë në vëmendje ndryshimet që ka sjellë në mjedisin global të sigurisë lufta në Ukrainë, ministri i Mbrojtjes tha se: “Pellgu Adriatik - Jon ka qenë një mjedis gjithnjë e më i aksesueshëm për të gjitha llojet e aktiviteteve malinje dhe është një nga pikat më të ndjeshme të transitit dhe infiltrimit në zemër të Evropës. Prandaj, bashkëpunimi ynë rajonal duhet të jetë në nivelin më të lartë, për t'i ofruar siguri dhe stabilitet popullit tonë. Ne kemi parë gjithashtu gjatë kësaj periudhe ndërhyrjen e aktorëve armiqësorë, që kërkojnë të degradojnë infrastrukturën tonë kritike, të ndërhyjnë në shërbimet tona qeveritare, të pengojnë aktivitetet tona ushtarake përmes sulmeve kibernetike. Për më tepër, Ballkani Perëndimor mbetet teatri i preferuar për palët e treta për të sfiduar parimet demokratike të shoqërisë. Koncepti Strategjik i NATO-s thekson rëndësinë e rajonit të Ballkanit Perëndimor për Aleancën. Prandaj, Shqipëria është e përkushtuar ndaj NATO-s, për të ofruar një mjedis të sigurt dhe stabilitet më të gjerë në Ballkanin Perëndimor”, - nënvizoi ministri Vengu.



Vazhdon procesi i Akreditimit në AFA

Në kuadër të ri-Akreditimit Institucional të AFA-së, përgjatë dy ditëve të fillim tetorit u zhvillua faza e dytë e këtij procesi nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, ekspertë të shquar me eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare në kontrollin dhe ruajtjen e sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë. Ekspertët e GVJ-së zhvilluan takime informuese me studentët e AFA-së, ato aktualë dhe të diplomuar, personel akademik, drejtues, civil dhe ushtarakë si dhe stafin ndihmës akademik dhe administrativ. Gjithashtu, ata u njohën nga afër me infrastrukturën e AFA-së, ambientet mësimore, stër-vitore dhe trajnuese që i shërbejnë formimit të oficerit në programet e studimit të AFA-së.



Akreditimi është një punë serioze, profesionale dhe një proces aspak i lehtë, por shumë i rëndësishëm për AFA-në dhe stafin e saj, të cilët me përkushtim, vullnet, punë sistematike dhe serioze ia arritën të përgatisin dokumentacionin voluminoz dhe çdo akt tjetër rregullator që garanton plotësimin e standardeve të cilësisë në të gjitha fushat.



Operacion SAR nga anija “Oriku”, pjesë e misionit të NATO-s në, detin Egje

Anija “Oriku”, gjatë patrullimit në Detin Egje, në bashkëpunim me Rojën Bregdetare greke dhe turke, ka finalizuar me sukses 3 operacione kërkim-shpëtimi, brenda 48 orëve të fundit, duke u ardhur në ndihmë emigrantëve të paligjshëm që rrezikonin të mbyteshin, pasi një nga mjetet e tyre ndodhej pa motor në kushte të vështira lundrimore.

Pas koordinimit të anijes “Oriku”, u arrit shpëtimi i 44 emigrantëve nga Palestina, Jemeni, Sudani, Afganistani, mes tyre gra dhe fëmijë. Të gjithë emigrantët ndodhen në gjendje të mirë shëndetësore dhe tashmë janë nën kujdesin e Rojës Bregdetare turke për procedurat e mëtejshme. Forca Detare/Roja Bregdetare vazhdon misionin e saj fisnik në kuadër të Aleancës, për shpëtimin e jetëve njerëzore.



Efektivë dhe mjete të Komandës Mbështetëse në ndihmë të komunitetit në bashkinë Vlorë

Forca dhe mjete të Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile, Batalionit të Xhenios dhe Batalionit të Transportit janë angazhuar për përmirësimin e situatës së krijuar si rezultat i reshjeve të dendura të shiut në bashkinë Vlorë.

Për heqjen e ujit nga pikat kritike të infrastrukturës të tilla si hidrovoqe, rrugë kryesore, pallate banimi, kanë punuar pa ndërprerje 23 forca, 8 mjete të tonazhit të rëndë, 3 mjete vetëshkarkuese dhe 6 motopompa thithëse të kapaciteteve të ndryshme.



Efektivët e BMEC-së bënë tërheqjen e ujit nga banesat, pastrimin e zonës, transportimin e inerteve, duke ndihmuar në lëvizjen e lirshme të qytetarëve me qëllim rikthimin në aktivitetin e përditshëm.

Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela ka qenë i pranishëm në qytetin e Vlorës për të monitoruar më nga afër situatën dhe punën e efektivëve, ku ka shprehur mirënjohje për angazhimin maksimal të strukturës së tij për të mbështetur komunitetin në rast të emergjencave civile.



U zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandantit të Bazës Ajrore Farkë

Në mjediset e Bazës Ajrore Farkë, u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandantit të kësaj baze. Në këtë ceremoni mori pjesë dhe komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo.

Komandanti në largim, kolonel Dritan Dyrnishi i kaloi flamurin e repartit komandantit të ri, nënkolonel Ervin Buzit.

Gjeneral brigade Dimo, shprehu vlerësim për kolonel Dyrnishin, për lidhshirësinë dhe shërbimin e tij, duke vlerësuar nivelin e lartë të gatishmërisë dhe profesionalizimit të treguar në komandimin e personelit të Bazës Ajrore të Farkës.

Gjithashtu, i uroi suksese në përbushje të detyrave në vijimësi, komandantit të ri, nënkolonel Buzit: “Me këto lëvizje dhe promovime të personelit, jam i bindur, - theksoi gjeneral brigade Dimo, - se do të vijohet të punohet edhe më shumë, edhe më mirë, duke qenë edhe më pranë problemeve dhe përballimit me sukses të sfidave që Forca Ajrore në përgjithësi dhe Baza Ajrore e Farkës në veçanti, kanë përpara. Vijueshmëria e projekteve ambicioze të modernizimit dhe infrastrukturës së Komandës së Forcës Ajrore, jo vetëm që do të mundësojnë arritjen e një stadi më të lartë të gatishmërisë dhe operacionalitetit. por edhe do të ofrojnë një mbështetje më të plotë e më të gjithanshme në mbarëvajtjen e punëve edhe në Bazën Ajrore Farkë, nën komandimin e një lidhshirësi të ri”.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Prej më shumë se 30 vitesh Shqipëria, e dalë nga një sistem totalitar, gëzon ditët e një demokracie ende ‘të brishtë’. Na duhet ende shumë kohë të kuptojmë kulturën e të ‘dirigjuarit’ demokraci.

A është demokracia zëri i njerëzve në veprim, zëri i atyre që kanë diçka për të thënë paqësisht dhe në qytetarisht?

Demokracia s’është thjesht një traditë apo dhuratë e trashëguar, e cila nxirret para të tjerëve që ta admirojnë si të ishte një rrobë e vyer. Demokracia është veprim, ndaj ajo duhet praktikuar, pa dëme dhe eksese.

Demokracia është diçka që duhet vënë në jetë në kuptimin e saj të parë. Dhe, si shprehia e çdo veprimi të sofistikuar, ajo duhet mësuar që kur jemi të rinj, në mënyrë që të mos harrohet më kurrë.

Demokracia, sistemi i fituar pas rënies së komunizmit, solli, përveç disa të drejtave që fituam, edhe lirinë më të rëndësishme, lirinë për ta shprehur mendimin lirshëm. Por pikërisht liria e fjalës është keqkuptuar nga shumë njerëz, të cilët s’bëjnë gjë tjetër veçse vjellin vrer në emër të saj.

Duket se mungesa e parimeve të demokracisë shqiptare nuk është nga zhvillimet dhe tendencat e sotme, por nga mënyra si kemi vendosur ta bëjmë atë që e kritikojmë. Sot nuk të mbetet asgjë për diskutim, pasi partitë dominohen nga ego personale dhe mbi të gjitha nuk kuptojnë realisht rolet e tyre. Ky vend, kjo shoqëri dhe sfidat e sotme e të nesërme meritojnë më shumë respekt, reflektim, maturim dhe ndryshim cilësor. Jetojmë në shekullin e 21-të, ku gjithçka ec me shpejtësinë e dritës, ku veç ‘mendimtarët’ politikë qëndrojnë stoikë në perceptimet e tyre të mbrapshta.

Nuk të duhet të mendosh shumë për të kuptuar si funksionon koncepti demokraci në Shqipëri, thjesht hap dritaren informuese dhe përballesh me lirinë e pakushtëzuar që ka sjellë demokracia në vendin tonë. Kaq bëra dhe unë, hapa televizorin, dhe pashë grupe njerëzish që në emër të ‘demokracisë’ po thyenin dhe shkatërronin çfarë mund të realizonte forca e duarve të tyre, dhe ndër mend më shkon batuta e të madhit Sandër Prosi tek filmi “Gjeneral Gramafoni”: “O popull sa gjëra bëhen në kurrizin tënd, madje dhe lartmadhënia dënon në emrin tënd!”. Rivijmë në kohë, fillim tetori i vitit 2024, në emër të ‘demosit’, pas një pasditeje argëtuese dëfrimi në lokalet e Tiranës, diku në muzgun e bukur vjeshtak bashkohen një grusht njerëzish dhe në marshimin e tyre të radhës përdorin lëndë piroteknike ndaj institucioneve si revoltë. Por lind pyetja: Kush është revolta e

Demokracia, “qeverisje e popullit, nga populli, për popullin”



këtyre njerëzve, të cilët përgjigjen e lanë në heshtjen e zakonshme të argumentit të munguar. Një protestë e dhunshme e Pyeta veten: pse duhen goditur policët, pse duhet të thyhen dyqanet, pse duhet t’u vihet flaka institucioneve?

Në një shtet demokratik partitë politike duhet të jenë para së gjithash demokratike brenda vetes së tyre, në mënyrë që ato të mund të prodhojnë demokraci për vendin dhe për të gjithë shoqërinë gjatë ushtrimit të pushtetit politik.

Në Shqipëri partitë politike kanë bashkudhëtuar bashkë me shtetin që prej krijimit të tij në fazat e konsolidimit. Organizimi i tyre politik i ka reflektuar origjinën e krijimit të tyre dhe ideologjitë mbizotëruese të periudhës kur kanë vepruar. Por faktori përcaktues në krijimin e identitetit dhe formësimin e rolit të tyre në sistemin qeverisës ishte dhe mbetet konteksti i brendshëm shqiptar me historinë, kulturën, normat dhe vlerat e tij.

Në vitin 1863, Abraham Linkoln e përcaktoi demokracinë si: “qeverisje e popullit, nga populli, për popullin”.

Si mund të kuptohet përmbajtja e kësaj thënieje të famshme?

Qeverisje e popullit do të thotë që pushteti buron nga populli. Populli është bartës i sovranitetit, që ushtron pushtetin ose jep mandatin për ushtrimin e këtij pushteti, dhe të gjithë ata që janë pjesë e këtij pushteti janë edhe përgjegjës përpara popullit.

Qeverisje nga populli do të thotë që pushteti ushtrohet nga përfaqësuesit e zgjedhur ose drejtpërdrejt prej qytetarëve. Qeverisje për popullin do të thotë që pushteti ushtrohet për t’i shërbyer interesave të popullit, domethënë, të mirës së përbashkët. Shqiptarët e kanë pranuar demokracinë, duke e parë këtë regjim si sistemin ideal politik. Kushtetuta e vendit tonë e miratuar në 1998 dhe me ndryshimet e saj ndër vite ka të mishëruar në përmbajtjen e saj qeverisjen demokratike, ndarjen e pushteteve dhe mbrojtjen e respektimit e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, vetë perspektiva e integritit në Bashkimin Europian, i jep Shqipërisë shtysa të forta drejt miratimit të akoma më shumë reformave demokratike. Liria, si e drejtë natyrore është thelbi i të menduarit sipas bindjeve individuale, bazuar kryesisht nga vullneti i lirë i të menduarit ndryshe nga tjetri, koncepti i lirisë përbën thelbin e zhvillimit dhe përparimit intelektual e shoqëror të njeriut.

Filozofi gjerman Friedrich Nietzsche, mendonte se liria është vullneti që të bën përgjegjës ndaj vetvetes, që ka për veti të të distancojë dhe të të veçojë nga ndikimet e të tjerëve për një pavarësi mendimi unik mbi këtë ekzistencë. Pa pasur liri dhe të drejta themelore nuk mund të kemi edhe politikë progresive, që të mund të shërbejë në të mirën e shtetasve të vet.

Njeriu si qenie, para së gjithash ka nevojë për liri e barazi, që të përjetojë të mirën brenda llojit. Filozofë të mëdhenj ardhur nga histori të ndryshme suksesi e kanë interpretuar në këndvështrime të ndryshme konceptin e demokracisë dhe përjetimet e saj sipas formimit të kulturave nga vijën, shumë u lodha të gjej se ku hyn të shpjeguarit e ‘demokracisë’ së shqiptarëve, nuk gjeta pikë lidhje me atë të kombeve të tjerë, përderisa qëndrojmë poshtë ballkoneve dikur për serenade, sot për të marrë direktiva si të shkatërrojmë pronën e përbashkët, të shkelim ligjin, të fyejmë dhe denigrojmë gjithkënd që mendon ndryshe, që do rregullin paqen dhe stabilitetin.

Me demokraci brezat e rinj po kuptojnë shtetin e të fortit atij me pistoletën në brez, ku fatkeqësisht vitit i mbrapshtë i ’97-ës armatosi popullsinë civile dhe çarmatosi përfaqësuesit e rendit dhe sot po këta njerëz të çekuilibruar me ligjin e ‘pasaportizuar’ të politikës destruktive atyre vite, kanosin rendin dhe sigurinë në vend. Këta njerëz e kuptojnë demokracinë si privilegj, që u është dhënë (dhëntë zoti mos t’i japin atribut hyjnore) jo më kot, ashtu si një pjesë që janë të ngulur si shushunja, nuk e kuptojnë se demokracia është sfidë dhe se demokracia e sfidon shpesh vetë demokracinë, nëse ajo nuk do të përmirësohet dhe respektohet.



NATO eksploron mënyra për të mbrojtur më mirë partnerët tregtarë në hapësirë

E kspertët e NATO-s, aleatët e hapësirës dhe përfaqësues të industrisë hapësinore u mbledhën në selinë e NATO-s në Bruksel për të trajtuar se si të rritet mbrojtja e partnerëve tregtarë kundër kërcënimeve hibride. Gjatë dekadës së fundit, sektori i hapësirës komerciale është rritur ndjeshëm, i nxitur nga përparimet e shpejta në teknologji dhe kërkesa më e lartë nga përdoruesit civilë dhe ushtarakë. Megjithatë, mundësitë e reja në hapësirë vijnë me rreziqe, dobësi dhe kërcënime të reja.

Gjatë Forumit të Hapësirës Tregtare në NATO, pjesëmarrësit diskutuan kërcënimet me të cilat përballen, nga sulmet kibernetike kundër sistemeve tokësore, te bllokimi ose mashtrimi i GPS dhe sinjaleve të tjera të komunikimit satelitor. Ata trajtuan gjithashtu rëndësinë e investimeve të mëtejshme në fusha të tilla si siguria kibernetike dhe shkëmbimi i informacionit rreth kërcënimeve.

Ndihmës Sekretarja e Përgjithshme e NATO-s për Investimet e Mbrojtjes, znj. Tarja Jaakkola, theksoi nevojën për një marrëdhënie të re midis sektorit ushtarak dhe atij tregtar, “ku të dyja palët mund të mësojnë nga tjetra dhe ku ne mund të mbështesim dhe shfrytëzojmë frymën e sipërmarrjes dhe inovacionin teknologjik thelbësor, për të mbajtur mbrojtjen tonë të fortë dhe efektive.” Forumi do të ndihmojë në hartimin e Strategjisë së parë të Hapësirës Tregtare të NATO-s vitin e ardhshëm, e cila do të përfshijë drejtimin për mbrojtjen e partnerëve të industrisë.

Qasja e NATO-s ndaj hapësirës

Hapësira është një zonë dinamike dhe me zhvillim të shpejtë, e cila është thelbësore për parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës. Në vitin 2019, aleatët miratuan Politikën Hapësinore të NATO-s dhe njohën hapësirën si një fushë të re operacionale, krahas ajrit, tokës, detit dhe hapësirës kibernetike. Kjo politikë drejton qasjen e NATO-s ndaj hapësirës dhe siguron mbështetjen e duhur të bazuar në hapësirë për operacionet dhe misionet e Aleancës në fusha të tilla si komunikimi, navigimi dhe inteligjenca.

Roli i hapësirës në një mjedis sigurie në ndryshim

Hapësira është thelbësore për parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës. Hapësira mbështet aftësinë e NATO-s për të lundruar dhe gjurmuar forcat, për të pasur komunikime të forta, për të zbuluar lëshimet e raketave dhe për të siguruar komandim dhe kontroll efektiv. Më shumë se gjysma e satelitëve aktivë që rrotullohen rreth Tokës i përkasin anëtarëve të NATO-s ose kompanive të bazuara në territorin e tyre.

Aleatët e NATO-s mbështeten gjithnjë e më shumë në hapësirë për detyra të ndryshme të sigurisë kombëtare, si dhe operacione ushtarake në mbarë globin. Të dhënat, produktet dhe shërbimet e hapësirës janë një mundësi kritike dhe mbështesin drejtpërdrejt fusha të tjera operacionale.

Evolucioni në përdorimin e hapësirës dhe përparimet e shpejta në teknologjinë hapësinore kanë krijuar mundësi të reja, por edhe rreziqe të reja, dobësi dhe kërcënime të mundshme. Ndërsa hapësira mund të përdoret për qëllime paqësore, ajo mund të përdoret gjithashtu për agresion. Përveç kësaj, satelitët mund të hakohen, bllokohen ose armatosen, dhe armët anti-satelitore mund të dëmtojnë komunikimet dhe të ndikojnë në aftësinë e Aleancës për të vepruar.

Disa vende, duke përfshirë Rusinë dhe Kinën, kanë zhvilluar dhe testuar një gamë të gjerë teknologjish kundër-hapësirës që mund të kufizojnë aksesin dhe lirinë e aleatëve për të vepruar në hapësirë. Rreziqe të ndryshme për sistemet hapësinore po rriten dhe mund të dëmtojnë sigurinë dhe interesat tregtare të aleatëve.

Koncepti Strategjik i NATO-s 2022 përsërit shqetësimet që aleatët kanë shprehur më parë për kërcënimet në rritje në hapësirë, duke theksuar se “konkurrentët strategjikë dhe kundërshtarët e mundshëm po investojnë në teknologji që mund të kufizojnë aksesin dhe lirinë tonë për të vepruar në hapësirë, të degradojnë aftësitë tona hapësinore, të synojnë civilët tanë dhe infrastrukturën ushtarake, dëmtojnë mbrojtjen tonë dhe dëmtojnë sigurinë tonë.”

Qasja e NATO-s ndaj hapësirës dhe rolet kryesore

NATO është një forum i rëndësishëm për aleatët për të shkëmbyer informacion, për të rritur ndërveprueshmërinë dhe për të koordinuar veprimet. Aleanca nuk synon të zhvillojë aftësitë e saj hapësinore dhe do të vazhdojë të mbështetet në asetet kombëtare hapësinore. Qasja e NATO-s ndaj hapësirës do të mbetet plotësisht në përputhje me ligjin ndërkombëtar. NATO nuk ka ndërmend të vendosë armë në hapësirë.

Nga këndvështrimi i sigurisë dhe mbrojtjes, hapësira është kritike për Aleancën, duke përfshirë në fushat e mëposhtme: Pozicionimin, navigimin dhe kohën, që mundëson goditje precize, gjurmim të forcave ose misione kërkim-shpëtimi; Paralajmërimi i hershëm, i cili ndihmon në sigurimin e mbrojtjes së forcës dhe siguron informacion jetik për lëshimet e raketave; Monitorimi mjedisor, i cili mundëson parashikimin meteorologjik dhe



planifikimin e misionit; Komunikime të sigurta satelitore, të cilat janë thelbësore për misionet për të mundësuar konsultimin, komandimin dhe kontrollin; Inteligjencën, mbikëqyrjen dhe zbulimin, të cilat janë thelbësore për ndërgjegjësimin e situatës, planifikimin dhe vendimmarrjen.

Për të zbatuar hapësirën si një fushë operacionale, Aleanca po rrit ndërgjegjësimin e fushës së saj hapësinore dhe kuptimin e përbashkët të mjedisit hapësinor, duke përfshirë kërcënimet dhe rreziqet. Ruajtja e ndërgjegjësimit për situatën dhe aksesin i besueshëm në shërbimet hapësinore janë thelbësore për të garantuar suksesin e operacioneve, misioneve dhe aktiviteteve të NATO-s.

NATO po zhvillon një Sistem Strategjik të Ndërgjegjësimit të Situatës në Hapësirë (3SAS) në selinë e NATO-s. Kjo aftësi do t'i lejojë Aleancës të kuptojë më mirë mjedisin hapësinor dhe ngjarjet hapësinore, dhe efektet e tyre në të gjitha fushat. Sistemi mbështetet nga 6.7 milionë euro financime nga Luksemburgu.

Ndërsa 3SAS fokusohet në shikimin lart në hapësirë, është po aq e rëndësishme për Aleancën që të zhvillojë asete që shohin nga poshtë Tokën dhe ofrojnë një pamje të qartë të asaj që po ndodh në terren. Për këtë qëllim, në takimin e ministrave të mbrojtjes të shkurtit 2023, një grup aleatësh të NATO-s së bashku me ish-të ftuarit (tani vende anëtare) Finlanda dhe Suedia ranë dakord të zhvillonin nismën e Aleancës për Mbikëqyrjen e Përhershme nga Hapësira (APSS). APSS do të rrisë bashkëpunimin në mbikëqyrjen e bazuar në hapësirë në mbështetje të zbatimit të politikës gjithëpërfshirëse hapësinore të NATO-s. Asetet e bazuara në hapësirë, të tilla si satelitët, mund të ofrojnë informacion në kohë reale mbi lëvizjen e forcave armike, kushtet e motit dhe terrenin – informacion thelbësor për të kuptuar fushën e betejës dhe marrjen e vendimeve të informuara. Ky mekanizëm i ri do të krijojë një plejadë virtuale në shkallë të gjerë të satelitëve të vëzhgimit kombëtar dhe komercial, të quajtur “Aquila”. Ai do t'i sigurojë Aleancës inteligjencë më të shpejtë dhe më të mirë, do të integrojë edhe më shumë të dhëna të bazuara në hapësirë në ekosistemin e inteligjencës së NATO-s dhe do të shfrytëzojë përparimet teknologjike nga sektori tregtar. Kontributi i hershëm i Luksemburgut prej 16.5 milionë euro ka hedhur bazat për këtë nismë transformuese dhe do t'u lejojë vendeve pjesëmarrëse të kontribuojnë në “Aquila” përmes aseteve, të dhënave dhe/ose fondeve të tyre. Të 19 aleatët pjesëmarrës të NATO-s janë: Belgjika, Bullgaria, Kanadaja, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Rumania, Spanja, Suedia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Aleanca po integron gjithashtu hapësirën në trajnime dhe ushtrime, planifikim operacional, zhvillimin e aftësive, si dhe në përpjekjet e saj për inovacion. Teknologjitë në zhvillim po transformojnë fushën hapësinore dhe NATO do të përfitojë nga

këto zhvillime për të ruajtur avantazhin e saj teknologjik. Në këtë drejtim, rrjeti i Organizatës së Shkencës dhe Teknologjisë së NATO-s ndihmon në rritjen e kapacitetit shkencor dhe teknologjik midis aleatëve dhe partnerëve.

Për të lejuar që forcat e NATO-s të komunikojnë më të sigurt dhe më shpejt, NATO po investon mbi 1 miliard euro në prokurimin e shërbimeve të komunikimit satelitor për periudhën 2020-2034. Ky është investimi më i madh i Aleancës në komunikimet satelitore, i cili ofrohet nga vendet anëtare të NATO-s dhe mundëson komunikime më elastike dhe fleksibël me anijet në det, mjetet ajrore dhe trupat anembanë globit.

Qendra Hapësinore e NATO-s

Qendra Hapësinore e NATO-s u krijua në vitin 2020 në Komandën Ajrore Aleate në Ramstein, Gjermani. Kjo Qendër shërben si pikë qendrore për të mbështetur aktivitetet, operacionet dhe misionet e NATO-s; ndarjen e informacionit; dhe të ndihmojë në koordinimin e përpjekjeve të aleatëve në fushën e hapësirës.

Qendra Hapësinore u drejtohet njërive kombëtare hapësinore për të siguruar që komandantët e NATO-s të kenë akses në të dhënat dhe shërbimet e kërkuara hapësinore. Përshtatja e kërkesave për produkte hapësinore përmes një entiteti të vetëm rrit reagimin e NATO-s dhe mbështet vendimmarrjen në kohë. Qendra Hapësinore ndjek nga afër zhvillimet në mjedisin e sigurisë hapësinore.

Në Samitin e Brukselit të korrikut 2018, udhëheqësit e NATO-s pranuan se hapësira është një zonë shumë dinamike dhe me zhvillim të shpejtë, e cila është thelbësore për sigurinë e Aleancës dhe ranë dakord të zhvillojnë një politikë gjithëpërfshirëse hapësinore të NATO-s. Në takimin e ministrave të mbrojtjes të qershorit 2019, aleatët miratuan Politikën Hapësinore të NATO-s. Në Takimin e Liderëve të Dhjetorit 2019 në Londër, aleatët shpallën hapësirën një fushë të pestë operacionale, krahas ajrit, tokës, detit dhe hapësirës kibernetike. Në deklaratën e tyre, liderët e NATO-s deklaruan: “Ne e kemi shpallur hapësirën një fushë operacionale për NATO-n, duke njohur rëndësinë e saj për të na mbajtur të sigurt dhe për të trajtuar sfidat e sigurisë, duke respektuar të drejtën ndërkombëtare”.

Në Samitin e Madridit të qershorit 2022, udhëheqësit e NATO-s miratuan Konceptin Strategjik 2022, dokumenti udhëzues që përcakton sfidat e sigurisë me të cilat përballen Aleanca dhe përshkruan detyrat politike dhe ushtarake që NATO do të kryejë për t'i adresuar ato. Përveç përshkrimit të kërcënimeve në rritje në hapësirë, Koncepti Strategjik përmban gjithashtu një angazhim nga aleatët për të “rritur aftësinë tonë për të vepruar në mënyrë efektive në hapësirë dhe hapësirë kibernetike për të parandaluar, zbuluar, kundërshtuar dhe përgjigjur spektrit të plotë të kërcënimeve, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion. ... Ne do të rrisim gjithashtu qëndrueshmërinë e hapësirës dhe aftësive kibernetike nga të cilat ne varem për mbrojtjen dhe sigurinë tonë kolektive.”

HISTORIA NËPËRMJET DOKUMENTEVE
5-8 nëntori 1944, kurset e para për përgatitjen
e oficerëve shqiptarë

Që nga qytetërimet e lashta, në shumicën e tyre, kanë qenë burrat ata që merrnin përgjegjësinë dhe angazhoheshin në çështjet ushtarake dhe luftarake... por jo gjithmonë. Gjatë gjithë historisë, ka pasur shumë gra që kanë udhëhequr kombet dhe drejtuar forcat ushtarake në luftë. Dhe kjo është veçanërisht e vërtetë për një komb si kombi ynë, që ka nxjerrë gra të tilla luftëtare, duke filluar nga Teuta e Ilirisë e Shota e Drenicës dhe, deri në një armatë vajzash e grash oficerë profesioniste sot.

Gratë shqiptare kanë ndezur risi dhe kanë bërë histori ushtarake dhe luftarake përgjatë gjithë historisë sonë kombëtare. Ato kanë lindur nga vetëmohimet, përkushtimet, zotësia dhe fisnikëria e tyre e madhe epike. Rëndësia e pjesëmarrjes dhe rolit të grave në forcën dhe formacionet ushtarake të vendit është një subjekt që kërkon një vëmendje të merituar nga historiografia ushtarake në veçanti, por edhe nga studimet historike shqiptare në përgjithësi. Ato kanë qenë gjithmonë prezent në ngjarjet e mëdha të historisë tonë, por masiviteti i tyre filloi në Luftën e Dytë Botërore, që përfshiu vendin dhe që vijoi me integrimin e tyre në Forcat e Armatosura pas çlirimit të Shqipërisë. Pas ndryshimeve të viteve ‘90, roli dhe rëndësia e gruas në formacionet ushtarake, u ridimensionua si pasojë e zhvillimeve dhe transformimeve që Forcat e Armatosura përjetuan në kushtet e demokracisë dhe të integritimit në NATO.

Ky ndryshim dhe “evolucion” shpjegon rrugëtimin e vajzave dhe grave në formacionet ushtarake, dhe duke filluar me faktet që tregojnë përfshirjen e parë të tyre në Forcat e Armatosura e deri në ditët tona, kur vajzat dhe gratë janë në çdo strukturë, armë dhe shërbim të forcës ushtarake të vendit. Dhe ato nuk janë vetëm oficerë. Vajzat dhe gratë tona janë të përfshira në uniformë ushtarake që në nivelet bazë si ushtarë dhe nënoficerë. Ato shërbejnë me një integritet, dinjitet dhe profesionalizëm të admirueshëm dhe për kolegët e tyre djem e burra në uniformë, nga nivelet më të ulëta dhe deri në ato më të larta të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura. Me përkushtimin dhe sakrificat, aftësitë dhe kontributin e tyre, ato kanë ndryshuar përgjithmonë peizazhin ushtarak modern të forcës ushtarake të këtij vendi. Gratë dhe vajzat në uniformë janë sot vlera, krenaria dhe fisnikëria e Forcave tona të Armatosura.

Shtimi i reparteve e njëjësive partizane, veçanërisht në vjeshtën e vitit 1944, solli nevojën emergjente të përgatitjes së kuadrove oficerë, edhe pse lufta për çlirim kishte arritur në fazën më të rëndësishme të saj. Referuar dokumenteve zyrtare të kohës, përgatitja e organizuar e kuadrove të ulët të ushtrisë shqiptare (atë kohë partizane) është bërë me vendim Nr. 560, datë 8 nëntor 1944, të Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional Çlirimtare, Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha. Kursi i parë ishte njëmuajor dhe u zhvillua në Berat. Në këtë kurs e të tjerët në vazhdim, po sipas urdhrave, merrnin pjesë dhe një numër i kufizuar i grave komandante-komisare partizane. Në vazhdim u bënë kurse të tjerë, por data 8 nëntor e vitit 1944, mbetet si data e nisjes së shkollimit të organizuar të oficerëve shqiptarë, në institucionin që më vonë do të quhej Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve “Enver Hoxha”.

Radiogram i Koçi Xoxes

Radiogram Nr. 63 dt. 13.XI.1944. Shtabit të Korparmatës së I Për njoftim, komisarëve të Divizioneve dhe z/v Komisarëve të Brigadave.

Duke marrë parasysh që ushtria po merr karakterin e një ushtrie të rregullt dhe se një numër i madh nevojash paraqiten si në pushtet ashtu dhe në sektorë të tjerë, duke u ndrojtur se shokët tanë mund të japin më shumë në këta sektorë, duhet të parashihet largimi i shoqeve nga ushtria dhe ngarkimi i tyre me punë të tjera.

Duke pasur kujdes që largimi i shoqeve të bëhet dalëngadalë, duke u gjetur edhe vende adapte ku do të punojnë pa qenë nevoja të bëhet bujë. T’u jepet të kuptojnë shoqeve tona se në këtë situatë, ato mund të japin më shumë në sektorë të tjerë që janë më të përshtatshëm për to’, se sa në ushtri. Natyrisht që do të qëndrojnë në ushtri ato që janë ngarkuar me përgjegjësi e janë të afta.

Një prej vajzave të para të ardhura në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” ishte dhe Veronika Murzaku-Shehu, e cila në kujtimet e saj mbi emocionet e uniformës ushtarake do të sillet mes librit “Oficeret shqiptare në rrjedhën e Historisë”, të gazetarëve, dalë po nga këto banka, Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzulla, ndjesitë dhe përgjegjësitë e këtij rrugëtimi.

Veronika Murzaku - Shehu: Ne skënderbegaset oficerë të luftës, që na u ndërpre karriera që në nisje

Veronika Murzaku është një nga ish-kuadrot partizane, që pas luftës u ul në bankat e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” me dëshirën e kualifikimit dhe vazhdimin e karrierës si oficerë aktive. Por pikërisht, ashtu si dhe tetë shoqet e saj, në kohën që duhet të nisinin këtë udhë të bukur e të vështirë si komanduese në radhët e ushtrisë së re që po reformohej mbi bazën e reparteve e njëjësive partizane, një urdhër zyrtar i shtetit të kohës që i përjashtonte femrat në radhët e ushtrisë aktive, ua ndërpret ëndrrën në mes. Tashmë, mbi këtë bazë, ato punuan me përkushtim në sektorë të ndryshëm, një pjesë edhe në reparte e njësi të ushtrisë së re, por jo si oficerë. Pra, Veronika Murzaku-Shehu, sot rreth 90 vjeç, është një nga partizanet që luftoi me armë në dorë në luftën për liri, e pas çlirimit, më 28 mars 1945, u ul në bankat e Shkollës Ushtarake “Skënderbej” për t’u shkolluar më tej si oficerë. Ajo, falë një kujtese fenomenale, flet me respekt për shokët e shoqet DEBATIK-ase, për shokët e luftës, e veçanërisht për 200 shokët e shoqet e para, që nisen mësimet pas luftës, në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Thotë se në kursin e parë në këtë shkollë me emër,



Të jesh grua në uniformën ushtarake

ishin gjithsej 9 vajza ish-partizane, ku shumica, kishin qenë kuadro drejtuese në repartet partizane, kryesisht në sektorin politik si komisarë apo me rininë. Ja rrëfimi i Veronikës: Unë jam një nga partizanet kuadro të luftës, që erdha në ditën e parë të hapjes së shkollës “Skënderbej” në Tiranë, me dëshirën që të përgatitesha e të vazhdoja karrierën si oficerë në ushtrinë që po riorganizohej pas fitores në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare. Por doli një urdhër që na përjashtonte ne vajzave ushtrimin e profesionit të oficerës, kështu që na dërguan më pas në fronte të tjera si nëpunëse. Pati prej nesh që shërbyen në ushtri, por jo si oficerë. Pra, kujtimet e mia më të shumta janë nga lufta dhe nga jeta në shkollën e lavdishme “Skënderbej”. Kemi qenë 9 vajza që nga radhët e brigadave në luftë, me armë, erdhëm dhe u ulëm në ditën e parë në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Por nga 9 që ishim, vetëm 5 e mbaruam misionin në këtë shkollë, të tjerat jo. Nuk është vendi, mendoj, të them këtu se pse ato u larguan nga shkolla. Pra, skënderbegaset e para në ditën që u hap shkolla, mes 200 të rinjve e të rejave, isha unë, Xhevrija Golemi me origjinë nga Kurveleshi, por me banim në Durrës dhe Katerina Prifti nga Tirana. Unë erdha në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” nga Brigada e 23-të Sulmuese, Xhevrija nga Brigada e V Sulmuese dhe Katerina nga Brigada e Parë Sulmuese. Që të tria, ishin fëmijë, 14 vjeçe, por të burrëruara në luftë... Unë kam lindur në Tiranë, më 29 prill të vitit 1930, nga një familje e njohur e me tradita patriotike. Kam një vëlla, Petrit Murzakun, ushtarak madhor dhe një nga sportistët më të njohur të vendit. Ne si familje, ishim të lidhur me luftën. Unë, ndonëse e re, isha anëtare e DEBATIK (Djemtë e bashkuar anëtarë të ideve komuniste) dhe merresha kryesisht me paketimin e shpërndarjen e komunikatave që shpërndaheshin në popull për mbështetjen e lëvizjes kundër pushtuesve të vendit dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Ishte një punë e vështirë, me rrezik, por që e bënim me pasion e bindje... Kam punuar atë kohë me Xhaferr Spahiun e shokë të tjerë... Thashë që isha e re, por rrethanat e kësaj pune, më detyruan të dal në mal, në njësitë partizane... Armiku, i mbështetur nga spiunët, kishte rënë në gjurmët tona, e unë bashkë me shokët u vumë në shënjestër të tyre. Puna në ilegalitet për ne u bë e vështirë, kështu që dolëm partizanë... Unë u rreshtova në Brigadën e 23të Sulmuese që vepronte në rajonin e Tiranës. Në radhët e saj qëndrova deri në çlirimin e vendit. Më pas, morëm urdhër që të nisinim mësimet në shkollën ushtarake për oficerë... Nuk e kisha menduar kurrë se jeta do merrte këtë rrjedhë... Pra, që në ditën e parë, unë dhe shoqe të tjera partizane, ishim pjesë e grupit të parë që do të nisinin shkollën për oficerë, duke qenë skënderbegaset e para. Isha shumë e lumtur. Në shkollë, kishim dhe armët me vete, ishim mësuar me to’. Vitet në shkollë përmbledhin kujtimet më të bukura të jetës sime. Vinim nga lufta, e sapo kishim prekur lirinë, për të cilën luftuam dhe na u vranë shokët. Ne tri shoqet, unë, Xhevrija dhe Katerina ishim në një klasë. Kishte pak dhe nga ata që i njihnim që në luftë, por u njohëm e miqësuan shumë shpejt, si motra e vëllezër. Kujtoj me respekt profesor Ganiun që na jepte frëngjisht, por që ishte për ne dhe si prind... Kujtoj kujdestarin tonë të vajzave Kadri Mullallin, kujdestarin Shuaip Laze, etj. Të gjithë na trajtonin si nxënës por dhe si prindër. Unë, me mësimet nuk e kisha të vështirë si shumë të tjerë, pasi kisha bërë ca vite shkollë, e kisha pasion librin... Lexoja shumë... Kam kujtime të mrekullueshme që nuk më janë larguar gjatë gjithë jetës. Më mbajnë gjallë, më japin forcë e dashuri... Pra, kujtimet janë shumë... Unë isha çapkëne, e shkathët si djalë. I mbaja flokët fare shkurt si djemtë dhe nuk dallohesha nga ata... Në shumë

raste, ‘ndëshkohesha’ dhe si ata. Një ditë, aty në katin e fundit të godinës, ku gjermanët kishin lënë ca krevate, ne e pastruam, i spostuam anash krevatet e po luanim futboll. Me djemtë, ishim dhe tri vajzat. Vjen drejtori Irfan Peshta i alarmuar (kishim bërë zhurmë e po shkatërronim mjediset) dhe na qorton rëndë. Më pas, thotë: “ju dy vajzat ikni në klasa, ndërsa djemtë ejani me mua në drejtori”. Pra, me djemtë isha dhe unë, se nuk dallohesha... Na kapi për veshi e po na fliste rëndë për veprimin... Në fund, e pa që mes djemve isha dhe unë, vajza. Shpesh, tek rendnim korridoreve, i kapja djemtë për qafe (me shaka), por përballesha dhe me të shtyra, më kujtonin si ndonjë nga shokët e tyre... Ishim me të njëjtën uniformë, dhe unë ‘çun’ pa flokë... Kisha rënë në sy dhe të drejtuesve të shkollës për çapkënlleqe, por një ditë më thirrën dhe për ndihmë. Ja si ndodhi. Në shkollë, merreshim dhe me aktivitete të ndryshme, sportive e kulturore. Xhevrijen, shoqen tonë, e caktojnë që të luajë një rol në dramën “Nëna” që po përgatitej për t’u vënë në skenë. Por ajo, hezitonte prerë. E thërret në zyrë drejtori i shkollës... Më thërret dhe mua, e pasi i kërkon me këmbëngulje të vazhdojë provat, duke u drejtuar nga unë i thotë: “Po ç’ është me ty xhanëm. Kjo shoqja jote Veronika puth pa teklif shkallëve skënderbegasit e se ka për gjë... Ty të vjen turp të luash një rol vajze në skenë?!”. Ja pra, dhe çapkënlleku im solli dhe të mira. Kështu, në Shkollën “Skënderbej” kaloi një vit, një vit i mrekullueshëm që nuk harrohet kurrë... Nuk di po kështu ndodhi. Kur do fillonte viti i dytë, një urdhër i Ministrit të Mbrojtjes, ishte që asnjë femër nuk do të ketë në radhët e ushtrisë. Na thirri ne vajzave dhe na e komunikoi Qamil Guranjaku, titullar në Ministrinë e Mbrojtjes. U pezmatuam, por ishte urdhër e nuk kishim çfarë të bënim. Më pas unë nisa punë në arkivin e Ministrisë së Mbrojtjes. Punonim për sistemimin e arkivave, përkatësisht të komunikatave të luftës e materialeve e dokumenteve të tjera. Ishte një punë e lodhshme por e bënim me dashuri e pasion. Ishim në liri, e Shqipëria e varfër, e rraskapitur, kishte shpresën për një jetë tjetër në liri... Ishim idealistë... Punuam 6 muaj në arkiv... Më pas, u ulëm përsëri në bankat e shkollës. Ne të tri vajzat skënderbegase, unë, Xhevrija dhe Katerina vazhduam më pas dhe shkollën pedagogjike. Unë e Katerina në Tiranë, Xhevrija në Durrës. Pas studimeve këtu, unë nisa punën si korrektore në gazetën “Bashkimi” dhe nga aty, më emëruan në Bankën Qendrore Tregtare si nëpunëse. Këtu punova tre vite. Më pas, bëra dhe një vit shkollë për gazetarë, e nisa më pas profesionin e bukur por dhe të vështirë të gazetarit. Nxirrnim revistën “Për Mbrojtjen e Paqes”, organ i Komitetit Për Mbrojtjen e Paqes. Këtu, në këtë revistë u njoha dhe me Nihat Shehun, ish-i burgosur në kampin e Mat’hauzenit, që u bë dhe bashkëshorti im e babai i dy fëmijëve tanë. Por pas tre vitesh, u suprimua ky komitet dhe unë nisa punë në Institutin e Shkencave, përkatësisht në sektorin e Meteorologjisë, deri sa dola në pension në vitin 1985, por nuk ndërpreva aktivitetin. Jam marrë me Komitetin e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si drejtuese në Tiranë e si aktiviste shoqërore. Por periudha e shkollës “Skënderbej”, mbetet periudha më e bukur e jetës sime. Kështu që dhe fati i shoqeve të mija të kësaj shkolle. Bënë një jetë normale, por fatkeqësisht jetuan pak, vdiqën shpejt. I kujtoj me shumë mall e respekt. Por dëshiroj që kur flitet dhe shkruhet për Shkollën Ushtarake “Skënderbej”, oficeret e luftës, ato të pas luftës, të mos shkruhet vetëm për djemtë, por dhe për ne vajzat, që na ndërprejnë këtë profesion në mes e qindra të tjera që e vazhduan dhe e vazhdojnë karrierën e oficerës aktive në radhët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Vajzat shqiptare që ranë për liri

Heroina e Popullit Hibe Palikuqi, komisarja trime partizane nga Dibra

Hibe Palikuqi u lind në qytetin e Dibrës në vitin 1927. Qysh në moshë të re u përfshi në veprimtarinë që zhvillonte rinia në qytetin e Dibrës dhe shtëpia e saj ishte bazë e LANÇ-it. Në vitin 1943 u arrestua bashkë me të ëmën. Pas lirimit nga burgu ajo vazhdon me pasion të shumëfishuar veprimtarinë e saj antifashiste. Më vonë u rreshtua në batalionin partizan të Dibrës. Do të vazhdonte më pas në radhët e Brigadës XVIII Sulmuese me detyrë zv/komisare kompanie. Mori pjesë në shumë luftime që kreu kjo brigadë në ato anë. Hibe Palikuqi ra dëshmore e Atdheut, më 23 shtator 1944, në luftimet që zhvilloi Brigada XVIII Sulmuese për çlirimin e Kërçovës.

Që në moshën 17 vjeçare, Hibe Palikuqit, iu besua detyra e komisaresh së kompanisë së dytë, të batalionit të katërt, të Brigadës XVIII Sulmuese Partizane. Vitet e fëmënisë të vajzës dibrane, Hibe Palikuqi, rrodhën të zbehtë, pa asgjë të veçantë nga ata të shoqeve të saj. Pasi kreu katër klasë të shkollës fillore, ajo u mbyll në shtëpi. Jashtë dilte e mbuluar me çarçaf dhe gjithnjë e shoqëruar nga njerëz të familjes. Fanatizmi kishte krijuar ligjet e veta, që s’mund t’i shkelte lehtë cilido. Por krisi pushka partizane dhe idetë e reja hynë në çdo shtëpi. Populli priste e dëgjonte me kënaqësi fjalët e luftëtarëve të lirisë. Edhe shtëpia e Sabrije Palikuqit, nënës së Hibes, u bë bazë e sigurt, ku shpesh kalonin dhe qëndronin ilegalët. Kështu që në vitin 1942, Hibja ra në kontakt me shokë ilegalë, të cilët strehoheshin përkohësisht në shtëpinë e saj, ose vinin për të marrë pjesë në mbledhjet që organizoheshin aty. Nën ndikimin e tyre Hibja u bë shpejt një propagandiste e shkathët në masën e grave. Ajo u mësonte grave dhe të rejave këngë partizane, organizonte mbledhje ndihmash për partizanët dhe kohën e grumbullimit të grave në stacionin e ujërave termale të Banishtit, e kthente në manifestime të hapura antifashiste, ku bisedohej e propagandohej për LANÇ-in. Veprimtaria e saj dhe dalja e vëllait të saj, Estrefit, në çetë në prill 1943, u bë shkas që fashistët ta burgosnin së bashku me nënën e saj dhe me motrën e vogël. Edhe në burg Hibja qëndroi ballëllartë. Me t’u liruar nga burg, Hibja u hodh edhe më me guxim në LANÇ. Vajza dikur e mbuluar me çarçaf, në prag të kapitullimit të Italisë fashiste, u pranua në radhët e Rinisë. Në manifestimin popullor që u organizua ditën që kapitulloi Italia fashiste, Hibja së bashku me 15 të reja dibrane u bashkua me manifestimet dhe, që atë ditë, u bë partizane efektive e batalionit të Dibrës.

Të gjitha detyrat që iu ngarkuan nga komanda partizane ajo i kreu me guxim, zgjuarsi e shkathhtësi. Pas luftës së Dibrës, nëntor 1943, forcat partizane u tërhoqën nga qyteti. Hibja u hodh në ilegalitet dhe veproi në zonën e Zhupes së Dibrës, në fshatrat Ballancë, Prapanik, Selcë etj. Aty vazhdoi punën agjitative në popull dhe udhëhoqi një aksion të armatosur kundër një autokolone në rrugën Strugë-Dibër. Okupatori, në bashkëpunim të ngushtë me parinë reaksionare të Dibrës, organizoi gjatë dimrit 1943-1944 një operacion të rreptë. Hibja hyri ilegalisht në qytetin e Dibrës dhe, duke kaluar nga njëra shtëpi në tjetrën, u tregoi qytetarëve se parullat helmuese të armikut ishin të gënjeshtra, se partizanët s’do vononin të ktheheshin përsëri për ta goditur përfundimisht armikun dhe tradhtarët.

Në pranverën e vitit 1944, Hibja u hodh rishtazi në batalionin partizan të Dibrës dhe, që me organizimin e Brigadës XVIII Sulmuese, më 18 gusht 1944, u caktua zëvendës komisar e kompanisë së dytë të batalionit të katërt, i cili, më 16 shtator 1944, mori urdhrin që të hidhej në Kërçovë në ndihmë të brigadave shqiptaro-maqedonase për të çliruar qytetin. Gjashtë ditë e gjashtë net udhëtoi batalioni. Shumë vështirë e patën partizanët gjatë rrugës. Hibja, megjithëse u lodh shumë, nuk u dha. Me këngën partizane në gojë, me optimizmin e thellë, ajo frymëzonte edhe shokët për të kapërcyer vështirësitë e rrugës, të mungesës së ushqimeve etj. Gjatë luftës, në një çast kritik, përpara kompanisë së



QË NË MOSHËN 17 VJEÇARE, HIBE PALIKUQIT, IU BESUA DETYRA E KOMISARES SË KOMPANISË SË DYTË, TË BATALIONIT TË KATËRT, TË BRIGADËS XVIII SULMUESE PARTIZANE. VITET E FËMINISË TË VAJZËS DIBRANE, HIBE PALIKUQI, RRODHËN TË ZBEHTË, PA ASGJË TË VEÇANTË NGA ATA TË SHOQEVE TË SAJ. PASI KREU KATËR KLASË TË SHKOLLËS FILLORE, AJO U MBYLL NË SHTËPI.

dytë doli detyra që, një skuadër, me kundërsulm, të zaptonte një lartësi e që aty të mbronte tërheqjen e kompanisë dhe të gjithë batalionit. Hibe Palikuqi u vu në krye të kësaj skuadre dhe me breshëri automatiku u sul drejt kodrës, por mitralozi armik e plagosi rëndë dhe ajo ra heroikisht.

Rapsodi popullor dibran, për të kujtuar heroizmin e kësaj bije trime, dekoruar me titullin më të lartë “Heroinë e

Popullit”, këndon:

“Shumë kish vuejt kjo Dibra plakë,/ Kudo tym e kudo flakë,

Kish vuejt shumë, por nuk u shtrëue./ Brof në kambë populli u çue./ Brigad’ t’re na ka formue,/ N’ at Kërçovë na paska shkue./ Gjermanët para i ka vue, / Shumë armiq o i ka farue./ - Kush asht ajo qi prin m’at anë?/ Po thot Hibja - Para partizanë!”

Qeriba Hoxha-Derri, luftëtarja e LANÇ-it

Qeriba Hoxha-Derri, luftëtarja e LANÇ-it, komandante dhe përgjegjëse e gruas, lindi në vitin 1905, në një familje me tradita atdhetare, në fshatin Matogjin të Vlorës. Idetë e mëdha të Rilindjes dhe të Pavarësisë Kombëtare, u ngulitën që kur ishte fëmijë tek Qeribaja. Ishte fëmijë 5-vjeçare kur nga jeta iu larguan babai dhe pastaj edhe nëna. Atë e zunë hallet dhe po rritej në mes të vështirësive e varfërisë. Rapsodi popullor i ka kënduar: “Qeriba, moj varfanjake,/ Moj e rritura bonjake,/ Jeta jote gjithë plagë,/ U rrite pa nënë e babë”. Të afërm dhe fisi Hoxha u kujdesën për të si për vajzën e tyre. Filloi të mësonte në shkollën e Matogjinit, ku mësues ishte atdhetari i madh, Halim Xhelo Tërbaçi. Ajo u martua me ushtarakun Shaqo Derri, i cili më vonë do të bëhej një nga atdhetarët e krahinës së Mesaplikut. Kështu Qeribaja përballoi me vendosmëri vështirësitë e jetës, përmes të cilave kalitej dhe bëhej e pathyeshme, sa në fshatrat Matogjin e Bashaj, e deri në Vlorë. Veprimtaria atdhetare e saj filloi që në Luftën e Vlorës 1920, ku u aktivizua në prapavijë si mbledhëse bukë e municione që dërgoheshin në vijën e frontit. Ajo merrej dhe me mjekimin e të plagosurve dhe ndihmonte familjet që ishin në vështirësi. ...Shaqo ishte oficer i Qeverisë së Nolit në vitin 1924.

Regjimi i mbretit Zog e ndoqi, por ai emigroi në Francë. Qeribaja mbeti në Smokthinë me familjen e të shoqit. Në vitin 1930, ajo siguroi vajtjen pranë bashkëshortit në Francë. Në Francë filloi një jetë e re. Ajo u takua me mësuesin e Matogjinit, Halim Xhelo. Të dy bashkë u ndodhën në krahë të tij. Qeribaja filloi të zhvillonte veprimtari dhe si aktiviste u zgjodh anëtare e Komitetit të Çlirimit Nacional (KÇN), që vepronte në mërgim. Ajo ishte e vetmja grua shqiptare që punonte me punëtorët francezë. Kjo detyrë e bëri që të mësonte frëngjishten. Qeribaja u bë kështu një aktiviste e palodhur dhe propagandiste e flaktë e idesë së çlirimit kombëtar në radhët e punëtorëve shqiptarë të emigruar në Francë. Si arkëtare e degës të KÇN-së, mbante ndihmat e grumbulluara nga punëtorët emigrantë shqiptarë për nxjerrjen e gazetës “Liria Kombëtare”.

Në vitin 1933, Qeribaja dërgohet me detyrë në Shqipëri, ku bëri lidhje me antizogistët, dhe shpërnda materiale propagandistike. Ajo e bëri disa herë rrugën nga Parisi në Shqipëri, duke plotësuar detyrat që i caktoheshin. Të gjithë fshatrat e Lumit të Vlorës e njihnin Qeribanë, sepse ajo dallohej si agjitore dhe grua e thjeshtë. Kur shkonte në Bashaj ajo vishej me çitjane labe, merrte tërkuzën dhe shkonte me shoqe në mal për dru e në ara për të punuar. Në këtë mënyrë ka vepruar për të humbur gjurmët e punës patriotike që bënte në popull, por sidomos me masën e grave dhe të vajzave. Ajo jetoi për një kohë të gjatë në Francë. Ishte labe e shqiptare në shpirt. Diskutonte me gra e vajza dhe dëgjohej me vëmendje prej tyre. Duke qenë anëtare e degës së Komitetit të Çlirimit Nacional, ndihmonte shokët për raportin që përgatitej lidhur me Shqipërinë. Në vitin 1937 vjen përsëri në Shqipëri. Shkon në Tërbaç, ku ngushëllon familjen e Halim Xhelos, për vdekjen e tij. Në vitin 1938 kthehet përsëri në Francë dhe raporton tek Ali Kelmendi për gjendjen në Shqipëri. Takohet dhe me anëtarë të organizatës “Bashkimi Kombëtar”, si me Qazim Koculin, Ali Këlcyrën, Bahri Omarin etj. Veprimtaria e saj patriotike dhe revolucionare, bëri që Qeribaja të përfshihej në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në vitin 1939, ajo bashkë me Shaqon kthehen në Shqipëri dhe shkojnë në fshatin Bashaj të Smokthinës. Që ditët e para të pushtimit fashist të Shqipërisë, edhe Qeribaja u rreshtua së bashku me luftëtarët e lirisë, për çlirimin e vendit nga pushtuesit. Qeribaja e gjeti Smokthinën dhe gjithë Mesaplikun që flakëronte nga lufta për çlirim, ku dëgjohej dhe kënga: “Moj krahinë e Mesaplikut/ Të griu gryka e çelikut/ Top e mortaj’ e armikut”. Dhe jo pak luftëtarë, e sidomos gra, mbledheshin rreth Qeribasë. Për veprimtarinë luftarake të Qeriba Derrit flasin edhe dokumente të armikut. Në raportin e zëvendësprokurorit të Vlorës drejtuar Policisë, më 31 dhjetor 1942, thuhet se midis 100 grave pjesëmarrëse, katër prej tyre janë kryesore, midis këtyre Qeriba Derri. Kuestura e Vlorës urdhëroi që kjo të largohet nga qyteti për Smokthinë.

Në telegramin që i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë nga zëvendës kuestori R.M. njoftohet se, më 2 janar 1942, demonstrata e grave e zhvilluar ditën nga gratë e poshtme dhe nga fakti se gjatë tre ditëve popullsisë i është shpërndarë vetëm gjysma e e racionit të bukës që është 150 gramë për person. Qeriba Derri, grua e Shaqo Derrit... burrat dhe prindërit e të përqendruarve janë thirrur dhe porositur dhe qenë marrë kundrejt tyre masat e më poshtme: Qeriba Derri të dërgohet në Smokthinë, që është fshati i saj dhe i burrit. Në këtë kohë, ajo ishte përgjegjëse e gruas për Mesaplikun. Shtëpia e saj u bë bazë e partizanëve dhe e ilegalëve. Fashistët kishin rënë në gjurmët atdhetare e revolucionare të saj dhe e kishin vënë në rreth të kuq. Qeribaja vepronte në qytet e në fshat,



sidomos në Mesaplik. Në korrik 1943, zgjidhet përgjegjëse e këshillit krahinor të gruas për zonën e çliruar të Mesaplikut, ku më parë kishte organizuar mbledhjen e grave dhe të vajzave në fshatrat Ramicë, Brataj, Tërbaç, Vranisht etj. Pranohet anëtare e partisë në celulën e Smokthinës.

Qeribaja u bë një organizatore e dalluar e grave në Lëvizjen Antifashiste të zonës së Mesaplikut e të Lumit të Vlorës. Ajo ishte e kudondodhur. Në operacionin e Dimrit të vitit 1943-1944, shoqëroi të plagosurit nga Bolena për në spitalin partizan të Poliçanit në Gjirokastrë. Ajo gjendej pranë nënave e motrave, të cilave u jepte kurajë, për rënien e luftëtarëve në luftë. Kështu vepronte edhe në radhët partizane, ku ishte në vijat e para të luftës dhe në prapavijë, duke vepruar me energji dhe pa u trembur nga vështirësitë. Ishte bërë e pranishme e gjendej në çdo vatër fshatari. Respektohej e nderohej jo vetëm në Smokthinë, por në tërë zonën e Mesaplikut dhe më gjerë, në Kurvelesh e Labëri. Populli i këndonte: “Në Shushicë kur u ktheve/ fishekë e gjerdan mbërtheve/ çave përpara s’u ktheve/ rrugët me gjak i leve”. Në Operacionin e Dimrit, në janar 1944, Qeribaja ndodhej bashkë me batalionin e dytë të Br. V S, në Grykë Pishë në Bolenë. Vendi ishte i mbuluar me dëborë. Korrieri që vinte nga Bolena soli lajmin se të gjitha rrugët për në Bolenë ishin të zëna nga gjermanët. Në këtë situatë kritike mbetej që rrethimi të çahet me sulm. Në këto çaste të vështira ajo u tregonte partizanëve episode nga heroizmi i komunarëve të Parisit, duke i mbushur luftëtarët me frymëzim për luftën e drejtë që bëjnë. Batalioni partizan vazhdoi rrugën për të çarë rrethimin, ndërsa ajo kaloi në pyjet e Çipinit, ku shumë familje smokthinjote ishin strehuar për t’i shpëtuar masakrave të nazi-ballistëve.

Në këto rrethana ajo mbajti lart moralin e popullit, të grave, por u diktua nga spiunët ballistë, u kap befasisht me të kunatin, Elmazin, e tradhtuar nga njerëz të shitur tek pushtuesi nazistë dhe e burgosën në burgun e Vlorës. E mbajtën disa javë në burg. E torturuan. I kërkoni të hiqte dorë nga lufta, nga ideat e saj. Por edhe në burg, ajo qëndroi e pamposhtur, si trimëreshë edhe u dha trimëri të burgosurve nga trimëria e saj. Edhe në burg, Qeribaja u fliste shoqeve të tjera për guximin që duhej të kishin vajzat dhe gratë shqiptare, për besimin që duhej të kishin në fitoren e luftës. Në njoftimin që prefekti i Vlorës i bënte Ministrisë së Punëve të Brendshme të Tiranës, nga Vlora,

më 28 shkurt 1944, thuhet se: “Kemi nderin t’ju njoftojmë se, më datë 14 të këtij muaji është arrestuar prej organizatave të Ballit Kombëtar të Vlorës gruaja e quajtur Qeriba Derri, bija e Muhametit dhe e Nefizes, bashkëshorte e ish-kapitenit Shaqo Derri, vjeç 36, pa fëmijë, lindur e banues në katundin Matogjin, Smokthinë të komunës Brataj... Qeribaja ka qenë një grua e rrezikshme komuniste dhe një nga eksponentët që ka zhvilluar propagandë në klasat femërore të kësaj prefektуре dhe të Gjirokastrës, madje duke qenë në bashkëpunim me çetat komuniste, e arratisur”.

Më 4 prill 1944, ballistët, mercenarët dhe nazistët e nxorën nga burgu bashkë me kunatin e saj Elmaz Derrin, si dhe partizanët Zenel Prushi, Çize Arifi dhe Refat Hila. I rreshtuan të pestë përpara ish-xhamisë së Tabakëve për pushkatim. Qeribaja në këto moment thirri: “Gjaku ynë do të merret...”. Në njoftimin që prefekti i Vlorës i dërgonte Ministrisë së Punëve të Brendshme të Tiranës, thuhet se: “Ju parashatrojmë se më datën 4.4.1944, në tregun e këtij qyteti u pushkatuan 5 (pesë) komunistë të rrezikshëm... Të ekzekutuarit janë: Qeriba Derri, komuniste e terroriste nga Smokthina, e burgosur. Bashkangjitur ju paraqesim dhe një shpallje me dy kopje rreth ekzekutimit të tyre”.

Armiktë e pushkatuan Qeribanë, por ajo mbeti e gjallë, jo vetëm në zemrat e smokthinjotëve, por të mbarë popullit shqiptar. Me qëndresën heroike, edhe pse ndodhej para pushkatimit, mesazhi i saj për shokët e shoqet bashkëluftëtarë ishte: “Lart zemrat!”. Dhe hyri në zemrat dhe këngën e partizanëve e të popullit dhe u dëgjua kënga: “Gjithë e panë Qeribanë,/ trimëreshën e paepur/ edhe përpara gestapos/ nuk iu shua buzë e qeshur”. ...Populli i këndoi Qeribasë: “Tek Sheshi i Vlorës, te xhamija/ shumë e hidhur historia/ Smokthinës iu vra e bija/ më lart u ngrit trimëria”. Qeriba Derri është shpallur dëshmore e Atdheut dhe Heroinë e Popullit. Emrin e saj e mban shkolla 9-vjeçare në Bashaj, si dhe një rrugë në qytetin e Vlorës. Për të është shkruar nga gjenerali Bako Dervishaj libri “Qeriba Derri - bija e Labërisë”. Për veprimtarinë dhe trimërinë e saj janë thurur dhe këndohen mjaft këngë, poezi, si dhe janë bërë skica e portrete, deri edhe Posta Shqiptare e ka etiketuar në një pullë zyrtare, etj. Në çdo përvjetor populli e nderon dhe përulet me respekt para jetës dhe veprës së saj heroike.

Antarktida po kthehet E GJELBËR

Nëse do t'ju kërkohet të vizualizoni Antarktidën, ka të ngjarë që një peizazh i madh i bardhë do t'ju lindte në mendje, por një studim i ri shqetësues mund t'ju bëjë të rimendoni atë imazh në kokën tuaj.

Ekspertët nga universitetet e “Exeter” dhe “Hertfordshire” kanë paralajmëruar se Antarktida po bëhet e gjelbër, duke bërë përgjegjëse ndryshimet klimatike.

Analiza e tyre tregon se mbulesa bimore në të gjithë Gadishullin Antarktik është rritur më shumë se dhjetëfish gjatë katër dekadave të fundit.

“Gjetjet tona ngrenë shqetësime serioze për të ardhmen mjedisore të Gadishullit Antarktik dhe të kontinentit në tërësi”, - tha Dr. Thomas Roland, i cili drejtoi studimin.

Studimet e mëparshme kanë treguar se, si shumë rajone polare, Gadishulli Antarktik po ngrohet më shpejt se mesatarja globale.

Në studimin e tyre të ri, studiuesit vendosën të kuptojnë se sa pjesë e zonës është ‘gjelbëruar’ në përgjigje të kësaj ngrohjeje. Ekipi analizoi imazhet satelitore të marra në të gjithë Gadishullin gjatë 40 viteve të fundit.

Në vitin 1986, pamjet tregojnë se vetëm një kilometër katror i Gadishullit ishte i mbuluar me bimësi. Megjithatë, deri në vitin 2021, kjo zonë ishte rritur në pothuajse 12 kilometra katrorë.


Duke folur për “MailOnline”, Dr. Roland shpjegoi se ndërsa fotot e thjeshta para dhe pas do të ishin ‘ndikuese’, ato nuk ishin të mundshme. “Mjerisht ne kemi vetëm imazhe me “rezolucion shumë të lartë” nga 2013 dhe 2016”, tha ai.

“Ndërsa rritja e vegjetacionit që vëzhgojmë në këtë dritare të shkurtër janë në përputhje me trendin tonë të përgjithshëm të gjelbërimit (1986-2021), ndryshimi vizual nuk është aq i jashtëzakonshëm!

Nga ana tjetër, një imazh i vetëm nga sateliti me rezolucion më të trashë që përdorim për studimin kryesor (ku kemi qindra imazhe gjatë gjithë periudhës 35-vjeçare), dyshoj, nuk do të perceptohej ‘cilësi’ aq e mirë sa të kishte ndikim”.



Studimi zbuloi gjithashtu se gjelbërimi po ndodh shpejt dhe më shpejt. Gjelbërimi u përshpejtua me mbi 30 për qind në vitet e fundit (2016-2021) në krahasim me periudhën e plotë të studimit (1986-2021), duke u zgjeruar me mbi 400 000 metra katrorë në vit në këtë periudhë.



“Bimët që gjejmë në Gadishullin Antarktik – kryesisht myshqet – rriten ndoshta në kushtet më të vështira në Tokë”, - tha Dr. Roland.

Peizazhi është ende pothuajse tërësisht i dominuar nga bora, akulli dhe shkëmbi, me vetëm një pjesë të vogël të kolonizuar nga jeta bimore.



“Por ajo pjesë e vogël është rritur në mënyrë dramatike, duke treguar se edhe kjo ‘shkretëtira’ e madhe dhe e izoluar po ndikohet nga ndryshimet antropogjene klimatike”.

Në mënyrë shqetësuese, studiuesit thonë se ndërsa këto ekosisteme bëhen më të krijuara dhe temperaturat vazhdojnë të rriten, shtrirja e gjelbërimit do të rritet.

Dr. Olly Bartlett, bashkë-autor i studimit, tha: “Toka në Antarktidë është kryesisht e varfër ose nuk ekziston, por kjo rritje në jetën e bimëve do të shtojë lëndë organike dhe do të lehtësojë formimin e tokës - potencialisht duke hapur rrugën bimëve të tjera të rriten. Kjo rrit rrezikun e mbërritjes së specieve jo-vendase dhe pushtuese, që mund të barten nga ekoturistët, shkencëtarët ose vizitorët e tjerë në kontinent”.

Bazuar në gjetjet, ekipi po bën thirrje për kërkime ‘urgjente’ në mekanizmat specifikë pas trendit të gjelbërimit. “Ndjeshmëria e bimësisë së Gadishullit Antarktik ndaj ndryshimeve klimatike është tashmë e qartë dhe, nën ngrohjen e ardhshme antropogjene, ne mund të shohim ndryshime thelbësore në biologjinë dhe peizazhin e këtij rajoni ikonik dhe të cenueshëm”, - shtoi Dr. Roland.

“Për të mbrojtur Antarktidën, ne duhet t'i kuptojmë këto ndryshime dhe të identifikojmë saktësisht se çfarë i shkakton ato”.

Në botën e sotme dixhitale me ritme të shpejta, qëndrimi përpara kërcënimeve të sigurisë kibernetike është kritikë për bizneset. Këtu gjeni një përmbledhje të disa prej tendencave teknologjike, makroekonomike dhe rregullatore që formësojnë industrinë e sigurisë kibernetike.

AI-ja si një kërcënim dhe një zgjidhje

Inteligjenca artificiale (AI) po revolucionarizon sigurinë kibernetike, duke ofruar përfitime dhe sfida të rëndësishme. Ndërsa AI-ja përmirëson zbulimin e kërcënimeve, gjuetinë dhe reagimin ndaj incidenteve, ajo gjithashtu fuqizon kriminelët kibernetikë. Inteligjenca artificiale gjeneruese, për shembull, mund të përmirësojë sulmet e phishing, duke eliminuar treguesit tipikë si gramatika e dobët, duke i bërë ato më të vështira për t'u zbuluar.

Organizatat tani përballen me sulme kibernetike të fuqizuara nga AI-ja që përshtaten dhe shfrytëzojnë dobësitë specifike. Kriminelët kibernetikë mund të përdorin modele të mëdha gjuhësore (LLM) të trajnuara për malware për të krijuar sulme të sofistikuara. Rreziqet kryesore përfshijnë injektimin e menjëhershëm, ku sulmuesit manipulojnë aplikacionet e AI-së në veprime të paautorizuara dhe trajtim të pasigurt të rezultateve, duke lejuar udhëzime me qëllim të keq nëse rezultatet nuk vërtetohen siç duhet.

Pavarësisht këtyre kërcënimeve, AI-ja ofron përfitime të konsiderueshme mbrojtëse. AI-ja mundëson njohuri më të thella të rrjetit dhe identifikim më të shpejtë të kërcënimit. Një raport i IBM-së, i vitit 2023 zbuloi se organizatat që përdorin AI-në dhe automatizim mund të identifikojnë dhe përmbajnë shkelje 108 ditë më shpejt se ato pa këto teknologji. Aplikacionet e AI-së në sigurinë kibernetike përfshijnë vërtetimin biometrik, zbulimin e kërcënimeve dhe reagimin ndaj incidentit. Për shembull, "Falcon" i CrowdStrike përdor AI-në për të zbuluar anomali si modele të pazakonta trafiku dhe akses të paautorizuar të të dhënave.

Peizazhi i sigurisë i drejtuar nga AI-ja po transformon rolet e sigurisë kibernetike. Një studim i shkurtit 2024 nga Konsorciumi Ndërkombëtar i Certifikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit (ISC2) zbuloi se 88% e profesionistëve presin që AI-ja të ndikojë ndjeshëm në punët e tyre. Megjithatë, 82% parashikojnë rritje të efikasitetit dhe 56% besojnë se AI-ja do të trajtojë detyrat rutinë, duke i lejuar ata të përqendrohen në aktivitetet me vlerë më të lartë.

Sulmet ransomware janë në rritje

Kërcënimet në zhvillim i ransomware vazhdon të sfidojë bizneset globalisht me sofistikimin dhe frekuencën e tij në rritje. 2023 ishte i dukshëm për sulme të pamëshirshme kibernetike. Disa kriminelë filluan të kopjojnë dhe vjedhin të dhëna, duke kërkuar shpërblim për mospublikimin e tyre dhe duke i shitur ato në rrjetin e errët.

"Check Point" raporton se një në çdo 10 organizata në mbarë botën u përball me tentativa sulmesh ransomware në vitin 2023, një rritje prej 33% nga viti 2022. Organizatat globalisht përjetuan mbi 60 000 sulme mesatarisht, që barazohet me 1 158 sulme për organizatë në javë. Viktimat e profilit të lartë përfshinin MGM, "Boeing" dhe "Royal Mail" të Mbretërisë së Bashkuar.

Pagesat e Ransomware në 2023 kaluan 1 miliard dollarë, duke shënuar një rekord të lartë, duke përjashtuar ndikimin ekonomik të humbjes së produktivitetit dhe kostot e riparimit. Industria e ransomware-ve tërhoqi shumë lojtarë të rinj, me "Recorded Future" që identifikoi 538 variante të reja ransomware në 2023. Trendi i "gjuetisë së lojërave të mëdha" u bë dominues, duke u fokusuar në më pak sulme, por duke kërkuar shpërblime më të mëdha, me pagesa që përfshijnë gjithnjë e më shumë shuma prej 1 milion dollarësh ose më shumë.

Kompanitë kryesore anti-ransomware përfshijnë "Gen Digital" (Avast dhe Norton), "Bitdefender", "Check Point Software", "CrowdStrike", "Illumio" dhe "Sophos".

Sulmet e zinxhirit të furnizimit

Sulmet kibernetike që synojnë zinxhirët e furnizimit të softuerit janë gjithnjë e më të përhapura dhe shumë përçarëse. Këto sulme mund të gjytmtojnë një zinxhir të tërë furnizimit, duke shkaktuar ndërprerje masive të biznesit.

Sipas raportit të IBM-së për 2023, kostoja e një shkeljeje të të dhënave, duhen mesatarisht 233 ditë për të identifikuar dhe 74 ditë për të mbajtur shkeljet të tilla, që arrijnë në 307 ditë. Kjo është 37 ditë më e gjatë se llojet e tjera të shkeljeve të të dhënave. Në vitin 2023, 15% e organizatave raportuan kompromiset e zinxhirit të furnizimit si burim i shkeljeve të të dhënave.

Sulmet e zinxhirit të furnizimit fituan rëndësi në vitin 2020 me hakerimin "SolarWinds", ku hakerat rusë futën kode me qëllim të keq në softuerin e kompanisë, duke prekur mijëra organizata, përfshirë qeverinë amerikane.

Anketa e Shkeljeve të Sigurisë Kibernetike të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar 2023 tregon se shumica e bizneseve të mëdha tani rishikojnë rreziqet e zinxhirit të furnizimit, me 55% të bizneseve të mëdha që vlerësojnë rreziqet e menjëhershme të furnizuesve, nga 44% në 2022.

Një sulm i rëndësishëm i vitit 2023 përfshiu MOVE-it, një softuer i menaxhuar i transferimit të skedarëve. Duke shfrytëzuar dobësitë e injektimit SQL, sulmuesit manipuluan të dhënat, zbuluan

Tendenca që ndikojnë në sigurinë kibernetike



informacione të ndjeshme, fituan privilegje administrative, filtronin skedarë dhe vendosën ransomware. Ky sulm preku organizata të tilla si BBC, Zellis dhe Norton, duke nënvizuar nevojën kritike për masa të fuqishme të sigurisë së zinxhirit të furnizimit.

Siguria e bazuar në renë kompjuterike

Pandemia e COVID-19 përshpejtoi adoptimin e reve kompjuterike ndërsa kompanitë kaluan në punë në distancë, duke rritur ekspozimin e tyre ndaj kërcënimeve kibernetike. Cilësimet e konfiguruar të gabuara të sigurisë në mjediset cloud janë bërë një çështje e rëndësishme, duke e bërë më të lehtë për sulmuesit vjedhjen e të dhënave.

Një studim i Thales i vitit 2023 thekson se bizneset përballen me sfida të shumta për shkak të një qasjeje me shumë re, së pari në cloud, me 79% të të anketuarve që përdorin më shumë se një ofrues cloud. Çdo ofrues shtesë prezanton kontrolle të reja sigurie dhe modele të mbrojtjes së të dhënave, duke komplikuar peizazhin e sigurisë.

Sondazhi zbuloi se 38% e të anketuarve identifikuan aplikacionet e softuerit si shërbim (SaaS) si objektivin kryesor për sulmet kibernetike, të ndjekur nga ruajtja në cloud me 36%. Gati gjysma (46%) raportuan se kishin përjetuar një shkelje të të dhënave në mjediset e tyre cloud, duke nënvizuar rrezikun që lidhet me ekspozimin e të dhënave në renë kompjuterike. Ndërsa kërcënimet kibernetike evoluojnë, organizatat duhet të rrisin masat e tyre të sigurisë për të mbrojtur burimet e bazuara në cloud.

Lojtarët kryesorë në sigurinë e cloud përfshijnë "Amazon", "Broadcom", "CrowdStrike", "Microsoft", "Alphabet", "Netskope", "Palo Alto Networks" dhe "Zscaler".

Siguria e bazuar në çip

Evolucioni i sigurisë së bazuar në çipa po bëhet thelbësor, pasi më shumë çipa integrohen në serverë kritikë për misionin dhe në aplikacione kritikë për sigurinë. Tendenca në rritje e shitësve të sistemeve dhe prodhuesve të pajisjeve origjinale (OEM) që dizajnojnë çipat e tyre e ka zhvendosur fokusin e kërkesave të sigurisë në një shqetësim më të brendshëm.

Zbulimi i vitit 2017 i dobësive të sigurisë së profilit të lartë si "Meltdown" dhe "Spectre" i detyroi shitësit e çipave të rregullojnë pikat e sigurisë me softuer, duke rezultuar në përmirësime të reduktuara të performancës për serverët e përmirësuar. Rrjedhimisht, shitësit filluan të zhvillonin arkitektura të personalizuar të çipave për të arritur performancë më të mirë dhe fitime të fuqisë, duke ruajtur kontrollin mbi sigurinë e çipit.

Peizazhi ekonomik i sulmeve harduerike ka ndryshuar, duke i bërë mjetet e hakerimit të aksesueshëm për kriminelët e zakonshëm. Ndërsa kompjuteri bëhet më i përhapur dhe i lidhur, sipërfaqja e sulmit zgjerohet, duke rritur gjasat e sulmeve harduerike. Njoffimi i koalicionit "OpenTitan" në shkurt 2024, për çipin e parë komercial të silikonit me siguri harduerike të integruar me burim të hapur ilustron këtë prirje. "OpenTitan" ofron një burim në çip të çelësve kriptografikë që janë të paarrtshëm nga distanca, duke siguruar infrastrukturë sigurie pa ndërhyrje.

Tendencat makroekonomike që ndikojnë

në sigurinë kibernetike

Konflikti në Ukrainë

Që nga aneksimi i Krimesë në vitin 2014, Rusia ka përdorur

taktika të sulmeve kibernetike kundër Ukrainës, me incidente të dukshme si sulmi i vitit 2015 në rrjetin elektrik të Ukrainës dhe sulmi i ransomware-it "NotPetya" i vitit 2017. Pushtimi i plotë rus i Ukrainës në shkurt 2022 përshkallëzoi frekuencën e sulmeve kibernetike në Ukrainë, me grupe të lidhura me Rusinë që synonin infrastrukturën kritike dhe sistemet e komunikimit. Sulmet me ndikim të lartë, si sulmi i dhjetorit 2023 ndaj Kyivstar, operatori më i madh i rrjetit celular të Ukrainës, nxjerrin në pah ndërprerjet e rënda të shkaktuara nga lufta kibernetike.

Sulmet e sponsorizuara nga shteti

Frekuenca e sulmeve kibernetike të sponsorizuara nga shteti pritet të rritet në vitin 2024, e nxitur nga zgjedhjet e shumta kombëtare në mbarë botën. Këto ngjarje shpesh katalizojnë sulme kibernetike të synuara që synojnë të prishin fushatat zgjedhore ose procesin e votimit. SHBA dhe Britania e Madhe janë ndër vendet që përballen me kërcënime të mëdha kibernetike gjatë zgjedhjeve të tyre. Rastet e mëparshme, të tilla si sulmet kibernetike të pasuksesshme gjatë zgjedhjeve parlamentare të Estonisë 2023 dhe ndërprerjet gjatë zgjedhjeve afatmesme në SHBA në 2022, nënvizojnë kërcënimin në rritje të aktivitetëve kibernetike të sponsorizuara nga shteti.

Mungesa e aftësive të sigurisë kibernetike

Hendeku global i fuqisë punëtore të sigurisë kibernetike arriti një rekord prej katër milionë njerëzve në vitin 2023, pavarësisht një rritjeje prej 9% të fuqisë punëtore në 5.5 milionë. Kërkesa për talentin e sigurisë kibernetike vazhdon të tejkalojë ofertën, e nxitur nga kompleksiteti në rritje i teknologjisë dhe detyra e pamëshirshme e sigurimit të sistemeve, rrjeteve dhe të dhënave kundër sulmeve kibernetike. Rritja e sulmeve të bazuara në AI përkeqëson më tej nevojën për profesionistë të aftë të sigurisë kibernetike.

Tendencat rregullatore që ndikojnë në sigurinë kibernetike

Rregulloret e Ransomware

Sulmet e Ransomware paraqesin një kërcënim të rëndësishëm për bizneset, duke rezultuar shpesh në humbje të konsiderueshme financiare. Përfshirja e zbatimit të ligjit në incidentet e ransomware mund të zvogëlojë koston totale të shkeljeve. Sipas raportit të IBM-së për vitin 2023, organizatat që përfshinin zbatimin e ligjit përjetuan kosto më të ulëta të shkeljes krahasuar me ato që nuk e bënë këtë. Megjithatë pagesa e një shpërblimi nuk është e paligjshme në shumë juridiksione, organizatat këshillohen kundër saj për shkak të kursimeve minimale të koston dhe pasojave të mundshme ligjore nëse pagesat u bëhen subjekteve të sanksionuara.

Legjislacioni i BE-së për sigurinë kibernetike

Direktiva NIS2 e BE-së, e miratuar në nëntor 2022, përcakton detyrime më të repta të sigurisë kibernetike për shtetet anëtare, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut, raportimin dhe shkëmbimin e informacionit. Vendet e BE-së kanë afat deri në tetor 2024 për të transpozuar direktivën në legjislacionin kombëtar. Direktiva synon të harmonizojë masat e sigurisë kibernetike në të gjithë BE-në, të përmirësojë bashkëpunimin dhe të krijojë një bazë të dhënash evropiane të cenueshmërisë. Për më tepër, Komisioni Evropian planifikon të miratojë rregullore për një skemë evropiane të certifikimit të sigurisë kibernetike (ECCS) në vitin 2024, duke mbuluar një gamë të gjerë produktesh IT dhe duke vendosur standarde të larta për komponentët e sigurisë.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Rrjedha e ngjarjeve të fillim vitit '97

Ushtaraku i lartë, gjeneral Sheme Kosova paraqitet para popullit shqiptar me shënime nga pranvera e stuhishme e vitit 1997, me librin e titulluar “Enigmat e ’97”. Libri është shkruar në formën e një ditari dhe rrëfimi të një ushtaraku madhor dhe paraqet interes të veçantë, sepse ushtaraku nuk u nda nga populli që e përgatiti për ta mbrojtur nga armiku dhe jo t’i drejtonte armët popullit. E veçanta e librit është së ushtaraku madhor në çdo hap që ka hedhur në këtë post e kishte të qartë “rolin dhe detyrën e FA-ve në mbrojtje të vendit e popullit nga armiqtë e jashtëm dhe jo të hapin zjarr ndaj popullit”. Autori, për një paraqitje sa më të plotë të ngjarjeve dhe të zhvillimit të tyre në një kohë të shpejtë, pjesën e parë të librit e përqendron në rrjedhën e ngjarjeve nga muaji janar deri më 2 mars 1997. Kush e ka përjetuar këtë situatë, përgatitet të ringjallë situatën e një tmerri të pashoq, të ndodhur gjatë jetës së tij. Ishte një rrëqethje e madhe e një populli që po përjetonte një dramë të madhe, por dhe të ushtrisë së tij, e cila u zhbë në një kohë rekord.

Rrëfimi i Gjeneral Kosovës paraqet interes, sepse na tregon ato që ndodhnin në kokën e ushtrisë dhe të shtetit që ne nuk i dimë. Gjatë kësaj periudhe të shpejtë dhe rrokullisjes së shtetit dhe të ushtrisë, ai sjell bisedat, përplasjet, planet, urdhrat që përgatiteshin e që jepeshin dhe që e çuan vendin në degradim. Falë kulturës ushtara

ke, gjenerali ka mbajtur shënime të shpejta, të thjeshta, por që sot dëftojnë nivelin dhe kulturën ushtarake të drejtuesve të shtetit që nga ministri i Mbrojtjes, nga Presidenti i vendit, nga gjeneralë dhe komanda ushtarake... Këto shënime kanë bërë bazën e këtij libri historik dhe të vlefshëm për çdo lexues të vëmendshëm për të njohur tablonë e këtij viti të mbrapsht, por dhe thelbin e dukurive që u shfaqën në ushtri, por dhe tek kuadrot ushtarakë në veçanti.

Gjatë leximit të librit na del figura e një ushtaraku, i cili u përlesh në mendime dhe në ide me drejtuesit e lartë, të cilët kërkonin në çdo urdhër dhe detyrë kundërvënie ndaj një populli që kishte dalë në rrugë për humbjen e fatit të tyre nga politika e mbrapshtë që iu servir, e për demokracinë që po ndërtohej. Përballë tyre qëndronte ushtaraku i devotshëm, që të gjitha energjitë i harxhonte në mbrojtjen e ushtrisë dhe të popullit. Por nuk arriti aty ku kërkonte detyra, ndaj dhe u dorëhoq me dinjitetin e ushtarakut.

Gjenerali u largua nga detyra, sepse nuk dëshironte të ishte ortak me anadollakët ideatorë dhe arkitektë të “rrugës së keqe”. Ai ndjente keqardhje për ato që ndodhnin, por moralisht ndihej i qetë në shpirt, sepse i dinte dhe i zbatonte ligjet e shtetit. Siç shprehet vazhdimisht, gjatë detyrës bëri sa munda, por i vetëdijshëm në të keqen e stërmadhe, përtej fuqive dhe autoritetit, nuk arriti që t’i ndalte në shtypjen e demonstratave me armë. Autori shprehet se shefat e tij dhe ata që u vunë në krye pas ikjes së tij, ishin jo vetëm më të shumtë në numër, por dhe të vendosur për t’i shkuar së keqes deri në fund.

Kur shkruhej historia e zezë...

Autori thekson se ja arritën qëllimit duke “nxirë përfundimisht biografinë e tyre dhe duke shënuar një faqe historie të zezë që nuk ka për t’u shlyer kurrë”. Ishin Safet Zhulali dhe Bashkim Gazidede, që i qëndruan besnikë shefit të tyre Sali Berisha. Shteti kishte marrë të tatëpjetën dhe rrokullima ishte e pandalshme. Ishin Zhulali dhe Gazidedja që u larguan drejt arratisë, duke pritur dhe shefin e tyre për t’ia mbathur, si dikur ballistët nga Shqipëria. Nga frika e hakmarrjes popullore u përgatit dhe suita e gjeneralëve dhe ushtarakëve të tjerë për largim... Këta ishin “trimat” që do të ruanin Shqipërinë nga sulmet e armikut të jashtëm, por armikun e gjetën në Shqipëri dhe ishte populli.

Viti 1997 është bërë një histori turpi për Shqipërinë. Ai vit është i zi, dhe vite e shekuj do të kalojnë përsëri, ai do të jetë një vit që nxin... në shekuj. Historia e vitit 1997, në gjithë përmbajtjen e tij, në thelbin e saj është një vepër e turpshme antipopullore dhe antikombëtare. Zanafilla kishte vite më parë që kishte nisur. Edhe shqiptarët që kanë lindur pas këtij viti, e që kanë mësuar apo dëgjuar për vitin 1997, i gjejnë menjëherë shkaktarët e vërtetë të gjëmës së madhe. Me fillimet e demokracisë, me popullin shqiptar u lajti mjaft bukur një tragjedi që pasojat e saj vijnë dhe sot. Çdo veprim që kryhej flitej për demokraci, por që në emër të

Rrëfimi i gjeneralit Sheme Kosova mbi enigmat e vitit 1997




antikomunizmit i hapi rrugë antidemokracisë. Në pushtet dhe në ushtri në krye të tyre u vërsulën njerëzit e paafte dhe “gangsterët u veshën me pushtet dhe bënë kërkinë me këtë popull e këtë vend, me pasuritë e pallogaritshme kombëtare e me gjithçka”, do të nxjerrë një nga përfundimet e shumta gjenerali në rrëfimet e tij. Këta të gjithë në sjelljen më të keqe luajtën me ideat, me atdheun dhe me popullin. Dhe kudo flitej për demokracinë që ata na kishin sjellë.

Pjesën më të shumtë të librit, autori ia ka kushtuar zhvillimit të ngjarjeve pas vendosjes të gjendjes së jashtëzakonshme. Pas 2 marsit, shteti po rrokullisej në greminë. Ushtria që ishte përgatitur për luftë ndaj armikut, u gjend e çarmatosur. Këtu gjenerali jep refleksione dhe bën analiza për atë që ndodhi dhe pse ndodhi. Me mjaft interes janë dhe replikat që autori ka bërë ndaj qëndrimeve të ministrit të Mbrojtjes Safet Zhulali, të veprimeve të paimagjinueshme të Bashkim Gazidedes, të rolit të SHIK-ut. Më tej shtjellon përkeqësimin e gjendjes dhe paraqet qëndrimin dhe aktet e Presidentit Sali Berisha, njëkohësisht

dhe të Komandantit të Përgjithshëm të FA-së. Mjaft analiza si: zgjedhja e presidentit dhe vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme, dorëzimi i shkresave dhe debate me Ademin, Çopani përplasjet me Gazideden në telefon, ç’mund të bënte ushtria..., etj., janë shumë të rëndësishme dhe e bëjnë më të plotë tabllonë e ngjarjeve tronditëse që po kalonte shteti shqiptar nga drejtimi i keq i kupolës së tij demokratike. Libri shpalos dhe një mision, atë që dosja e zezë e ’97-s, e cila ishte klasifikuar për të mos u hapur kurrë, tashmë ajo është plotësisht e hapur dhe e zbardhur për të gjithë.

Libri “Enigmat e ’97” u hap dhe është një dëshmi e fortë, e qartë dhe e detajuar me personazhe konkretë të kësaj dosje të zezë të vitit 1997. Gjërat janë të qarta, të dukshme, pasi dëmi është “kolosal dhe i parikuperueshëm”, përfundon autori. Autori me shqetësim në këtë libër analizë thekson se “përgjegjësit që e gatuan ’97-n, nuk janë ndëshkuar ende”, dhe më tej “ata u lejuan të merren sërish me politikë, të vishen me pushtet dhe t’i sjellin fatkeqësi të tjera këtij vendi e këtij populli”. Demokracinë që prunë në Shqipëri, e prunë me rrëmuje, me vjedhje të zgjedhjeve



si në majin 1996, ndërsa sot bërtasin më shumë për votën e lirë. Në vitin 1997 kulmi u arrit me lulëzimin e firmave piramidale të fajdeve dhe e çuan vendin në një kasaphanë të vërtetë dhe rebelim popullor, të përqendruar në jug të vendit. Kështu shkaku ishte politika e keqe, ndërsa protestat iu kundërvunë kësaj politike. Dhe pranvera e ’97-s i vuri zjarrin Shqipërisë dhe mori mijëra njerëz të vrarë.

Rrëfime të besueshme të një ushtaraku

Gazeta londineze “The Independent” do të shkruante për pranverën e vitit 1997 në Shqipëri se regjimi i Tiranës është një regjim gangsterësh, më tej vijon se sa para kanë hyrë nëpërmjet kontrabandës në Shqipëri, nuk do të mësohet asnjëherë. Në këtë vit shqiptarët humbën kursimet e tyre, ndërsa regjimi i Berishës po përmysej, paratë e refugjatëve dhe fitimet e kontrabandës u zhdukën pa gjurmë. E ndërsa shteti, ushtria dhe atdheu i tyre, u shkërmoqën, politika këmbëngulte për shtypje të revoltave, paratë e shqiptarëve nuk hynë për të ndërtuar por t’i vënë flakën Shqipërisë. Paratë u keqpërdorën nga pushtetarët e kohës, për pasojë investimet erdhën gjithmonë duke u zvogëluar deri në ndërprerje. Infrastruktura nuk mbeti e mëparshmja, por u përkeqësua... Të gjithë këto shkatërime që tregojnë Gjenerali, ndodhën para syve të tij dhe të popullit shqiptar, ndaj dhe ka shkruar për të treguar. Këto rrëfime të tij janë të besueshme për faktin se ishte në një post madhor, por ai i tregon thjesht ngjarjet, faktet dhe emrat ku ka qenë i pranishëm, por se dhe populli të gjitha veprimet i ka parë me sytë e tij dhe ende i ka në memorie.

Luftë s’ ishte, por lufta gjendej e pranishme në çdo hap të gjeneralit që kundërshtonte, që iu kundërvihej, për të mos ngritur krye mendimi i mbrapsht dhe jo i bazuar në rregullore, ligje dhe në kushtetutë. Libri na dëshmon se Sheme Kosova me veprimet dhe qëndrimet e tij, i ka thënë ndal së keqes së madhe antikombëtare. Gjatë leximit të librit në çdo germë të tij, ndjen respekt për një ushtarak të tillë, që na paraqitet me personalitet dinjitoz dhe ushtarak i përgatitur. Gjeneral Kosova edhe në libër qëndron midis nesh, i thjeshtë, i qartë dhe i përkushtuar për detyrën si ushtarak dhe jo për shpërdorimin e ushtrisë, që u shfaq në atë vit nga mjaft ushtarakë që e çuan ushtrinë drejt shpartallimit total.

Libri na flet për një stërmundim të jashtëzakonshëm në muajt e parë të vitit 1997, ku gjeneral Kosova u përpoq dhe luftoi për të mbrojtur ushtrinë nga shkatërrimi. Dorëheqja si shef Shtabi, ishte një gjest fisnik, ishte paralajmërim i gjendjes së jashtëzakonshme, ishte kulmi i së keqes, ishte vula e shkatërrimit total të ushtrisë dhe shtetit. Gjatë rrëfimit gjenerali pohon në mjaft raste të takimeve me drejtuesit e shtetit për zgjidhje politike të situatës dhe jo me forcën e armëve të ushtrisë. Gjendja e jashtëzakonshme u vendos, po ajo shpejtoi të jashtëzakonshmen e ndodhisë që ndodhi. Dhe shkaktarët e kësaj fatkeqësie kombëtare, ndër të cilët spikasin tre vetë: Sali Berisha, Safet Zhulali dhe Bashkim Gazidede. Në këtë godinë ngrehinë të pushtetit gjendej siç shprehet autori “një tufë e madhe servilësh dhe injorantësh të paskrupullt”. Kështu, ne gjatë leximit të librit mësojmë se “shteti tregoi fytyrën e tij gjakatare, shteti iu kundërvu popullit të vet me falangat e tij të bindura dhe të verbra si SHIK-un, policinë dhe ushtarakë të paformuar dhe të pa përgatitur atdhetarisht, shteti vrau mjaft njerëz të pafajshëm, të varfër dhe të vobektë, deri sa ra edhe vetë i turpëruar, i dërrmuar, i shkërmoqur.

Mbrojtja me konsekuencë figurën e ushtarakut

Këto rrëfime janë të besueshme se karriera e tij ushtarakë nisi nga oficer i thjeshtë deri në shkallët më të larta të hierarkisë ushtarakë, të cilat tregojnë aftësitë, karakterin dhe qëndrimin e një ushtaraku që e do dhe e mbron atdheun. Ato që shkruhen në libër janë të vërtetë siç kanë ndodhur në atë kohën dhe në ambientin e përshkruar. Gjenerali ishte një dëshmitar i të vërtetave, pasi faktet dhe ndodhitë e hidhura, i pa me sy dhe i dëgjoi me vesh e i lexoi në urdhrat copa-letre, pa këmbë e pa kohë, siç ishte dhe shkarkimi i tij në këmbë dhe emërimi i një ushtaraku tjetër po aty në këmbë. Kështu u katandis ushtria shqiptare në vitin e mbrapsht në histori 1997. Ky libër rrëfimtari, është dhe një apel që i bëhet ushtarakut për të punuar me ndershmëri dhe patriotizëm, ushtria nuk të bën të pasur, por të jep fisnikëri dhe madhështi njëkohësisht. Nëpërmjet këtyre rrëfimeve, ushtaraku i lartë na thotë të gjithëve se “kjo ishte puna, këto ishin arritjet, na tregojnë vlerësimin për reformën në ushtri të kuadrove, për përkushtimin dhe dashurinë e tyre për atdheun”. Në praktikën e përditshme të punës metoda e një ushtaraku është komunikimi me eprorët

dhe vartësit, gjithmonë të përkushtuar për të mbrojtur ushtrinë, për të realizuar detyrat e funksionit dhe kompetencave sipas rregullave dhe ligjit.

Në këtë libër gjejmë një pjesë të historisë së ushtrisë, e cila do të analizohet në shekuj. Në vitin e enigmave 1997, ka porosi dhe urdhra për veprime të ndryshme që nuk janë përshkruar, por që japin detaje për kuadrin e ngjarje dhe portretizim të personazheve. Kështu gjenerali polemizon dhe replikon në një mënyrë elegante me ish-kolegë gjeneralë, me politikanë dhe shkrime tendencioze. Gjatë leximit të librit arrihet në përfundim se e vërteta dhe e drejta historike gjenden tek figura e ushtarakut të lartë Sheme Kosova, dhe jo në njerëzit e tipit Berishë, Gazidete e Zhulali, që e çuan vendin në greminë me urdhrat e tyre mediokër dhe antikombëtare. Gjykimi dhe mendimi i pastër dhe i logjikshëm i ushtarakut në situata mjaft të vështira, tregon pjekuri, por dhe njohje e respektim të ligjit, të kushtetutës dhe të figurës së ushtarakut. Të gjitha rrëfimet e gjeneralit të bëjnë krenar dhe të shtojnë admirimin dhe respektin ku ushtaraku shfaqet dhe manifeston dinjitet, atdhedashuri dhe personalitet.

Libri që ka publikuar gjenerali madhor është në kohë. Ai të gjitha problemet dhe shqetësimet i ka ngritur që herët, por të përmbledhur në një vëllim, tashmë i erdhi koha për t’i bërë publike dhe njerëzit të shikojnë me fakt ata që nisen të ndërtonin demokracinë, por e kthyen në të kundërt, duke i treguar dhëmbët dhe armët popullit që ai të bindej, siç kanë bërë regjimet antipopullore, pazotësi për të drejtuar dhe udhëhequr një popull punëtor dhe bujar. Libri jep njëkohësisht shumë mesazhe për politikën, por në mënyrë të veçantë për ushtarakun, për njohjen dhe zbatimin e detyrës së tij. Gjenerali e mbrojti fort vendin e punës përballë politikës, nuk lejoi që nëpërmjet ushtrisë e cila mbron atdheun nga armiku i jashtëm, ta kthente ushtrinë kundër popullit, këtë e bëjnë juntat ushtarake. Gjenerali e mbrojti ushtrinë dhe nderin e ushtarakut, por servilët ushtarakë më pas e shkatërruan ushtrinë, shtyllën kryesore të shtetit. Libri jep një shembull se si punohet dhe luftohet për të ruajtur dinjitetin e ushtarakut dhe për të qenë njerëzor në jetë, edhe në situata tepër të vështira.

Vlerësoj dhe çmoj punën plot kulturë të redaktorit të librit, Xhevdet Shehu, i cili e cilëson këtë libër se “gjeneral Sheme Kosova hap dosjen e zezë të vitit 1997”. Me nota maksimale ai e vlerëson rrëfimin e gjeneralit dhe me besim se është një libër historik për politikën dhe ushtrinë, si dhe shfaq besimin se libri do të shërbejë si një burim i rëndësishëm për historinë.

Njohje me gjeneralin...


Sheme Ismet Kosova, ka lindur me 24.03.1949 në Lumas të Beratit. Pasi mbaroi shkollën 7-vjeçare në fshatin e lindjes, Lumas, vijoi shkollën e Mesme Pedagogjike në Tiranë “Ndrec Ndue Gjoka” dhe e përfundoi të mesmen në Berat në shkollën “Babë Dedë Karbunara” me rezultate shumë të mira. Punoi mësues në shkollën 8-vjeçare për dy vite.

Më tej nisi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë dhe u titullua oficer për zbulimin në dhjetor 1971. Nisi detyrën ushtarakë në Regjimentin e Zbulimit në Zall-Herr të Tiranës, në të cilën u përgatit dhe si specialist i Parashutizmit shqiptar ushtarak. Në këtë detyrë punoi për tre vite me trupën dhe kuadrot e zbulimit të Ushtrisë. Me emërimin në Shkollën e Përgatitjes së Kuadrove Rezervistë në Zall-Herr bëri detyrën e instruktorit të përgatitjes taktike, të komandantit të kompanisë të batalionit të këmbësorisë.

Në vitet 1979-1981 mbaroi Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm me rezultate shumë të larta. Në akademi u përgatit për drejtim e komandim operativ-strategjik të njësisë në FA. Në vitet 1981-1986 kreu detyrën e shefit të Shtabit të Brigadës Këmbësore në Durrës, ndërsa në vitet 1987-1989 kreu detyra në njësitë ushtarake në Fier dhe në njësitet e Manzës e Sukthit në Durrës. Me ndryshimin e sistemit, në vitet 1991 u emërua në detyrën e shefit Shtabit të Divizionit në Shijak dhe më pas Komandant Divizioni me gradën ushtarakë “kolonel”. Në shtator 1992 u emërua nga Këshilli i Ministrave drejtor në Drejtorinë Operative dhe të Stërvitjes në Ministrinë e Mbrojtjes. Në vitet 1991-1995 ka kryer kurse, seminare e kualifikime në Akademi Ushtarakë në Turqi, Gjermani, Itali e në NATO. Ka marrë vlerësime nga eprorë si ushtarak reformator me nivel të lartë, profesional, politik, organizator e partner shumë i mirë.

Më 26.06.1994 u emërua në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së në Republikën e Shqipërisë. Në janar 1995 iu dha grada ushtarakë “gjeneral” (gjeneral me katër yje), grada më e lartë ushtarakë në Shqipëri. Detyrën e lartë ushtarakë e kreu me përkushtim, përgjegjësi, devotshmëri, duke iu përmbajtur detyrës, ligjeve, kushtetutës dhe betimit ushtarak.

Në vitin 1997 Gjeneral Kosova tregoi atdhetari, kulturë profesionale, guxim, dinjitet dhe qëndrim dinjitoz si ushtarak. Si shtetar dhe drejtues i lartë ushtarak, i papajtuashëm me urdhra që binin ndesh me Kushtetutën dhe betimin ushtarak, me vullnet të plotë dha modelin e dorëheqjes nga detyra ushtarakë, më 2 mars 1997. Dorëheqjen e tij e mbështeti në pamundësinë për vazhdimin detyrës në përputhje me Kushtetutën, nderin dhe gradën e gjeneralit. Doli në lirim me vendim gjyqësor në vitin 2007 dhe në pension në vitin 2014.



DY BURSA TË PLOTA STUDIMI STUDIME USHTARAKE NË SHBA

- Akademia Ushtarake Detare, 1 (një) kuotë
- Akademia Ushtarake "West Point", 1 (një) kuotë

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit
pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më:
23 tetor 2024